



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

PROGRAMI I MAGJISTRATURËS: DREJTIMI JURIDIKO – PENAL

TEZA E MAGJISTRATURËS:

**“KRIMI I ORGANIZUAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË
VERIUT – ME THEKS TË VEÇANTË PËRGJIMET NGA VITI 2014/2018”**

KANDIDATI

Elma Imeri

MENTORI

Prof.Dr.Ismail Zejneli

Tetovë,2020

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE.....	4
II.	Lënda e hulumtimit.....	5
III.	Qëllimet e hulumtimit.....	6
IV.	Hipoteza	7
V.	Metodologjia e hulumtimit.....	10
KAPITULLI I		12
1.	Kuptimi për krimin e organizuar dhe veprat penale.....	12
1.1	Kuptimi për „krimin e organizuar”	Error! Bookmark not defined.
1.2	Analiza e karakteristikave të krimit të organizuar modern.....	16
1.2.1	Problemet gjatë të kuptuarit të krimit të organizuar	16
1.2.2	Ridefinimii krimit të organizuar nën ndikimin e trendeve modern	18
1.3	Kushte për veprimin e krimit të organizuar	20
1.4	Dimensionet globale të krimit të organizuar	21
1.5	Veprat penale dhe definimil tyre në aspektin juridik	22
1.5.1	Pjesëmarrja e më shumë personave në kryerjen e veprës penale	23
KAPITULLI II		25
2.	Format e krimit të organizuar	25
2.1	Nocioni për teroroizmin dhe krimin e organizuar dhe lidhëshmëria ndërmjet tyre	25
2.1.1	Definimii termit – terorizëm	27
2.3	Larja e parave.....	34
2.3.1	Definimiinocionit larja e parave.....	35
2.3.2	Financimii terrorizmit.....	36
2.3.3	Fazat në procesin e larjes së parave	38
2.4	Tregtia me njerëz	39
2.5	Tregtia e paligjshme me drogë dhe substanca psikotrope	41
2.6	Kriminaliteti dhunshëm dhe pronësor	43
2.7	Sajber krimi dhe sajber siguria.....	43
KAPITULLI III		45
3.	Krimii organizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	45
3.1	Vëllimi dhe struktura e krimit të organizuar në teritorin e RMV	45

3.2 Shtypja dhe parandalimi i krimit të organizuar në RMV.....	46
3.3 Roli dhe veprimi i organeve kompetente në luftën kundër krimit të organizuar.....	49
KAPITULLI IV	55
4. Hulitimi i rastit – Bisedat e përgjuara në periudhën prej vitit 2014 – 2018 në RMV.....	55
4.1 Kuptimi për ndjekjen e komunikimeve	55
4.2 Procedura për ndjekjen e komunikimeve për zbulimin dhe ndjekjen kryesive të veprave penale në fushën e krimit të organizuar.....	57
4.3 Procedura për ndjekjen e komunikimeve për arsye të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit	60
4.4 Bisedat e përgjuara në periudhën prej vitit 2014-2018 në RM	61
4.5 Formimi i Prokurorisë Publike - PSP.....	65
4.6 Kompetencat dhe detyrat e prokurorëve special publik	68
4.7 Roli i operatorëve mobil gjatë ndjekjes së komunikimeve	70
VI Diskutimi:	Error! Bookmark not defined.
HIPOTEZA E PËRGJITHSHME	7
HIPOTEZAT E VEÇANTA	9
VII Përfundimi:	75
Literatura e përdorur:	77

I. HYRJE

Termi krim vjen nga fjala latine që nënkupton kriminalitetin. Aktivitetet që dalin nga veprimet kriminale janë të ndaluara me ligj. Këto janë veprime që e rrezikojnë pronën, integritetin e individit dhe vlerat e bashkësisë njerëzore. Janë këto veprime përhapja e të cilave mund ta rrezikojë funksionimin e shoqërisë. Veprimet kriminale janë: deliktet pronësore, kundërvajtjet në trafik, shkeljet morale, krimi ekonomik, shkeljet politike dhe të ngjashme.

Veprat penale nuk dallohen vetëm nga lloji, por edhe nga motivacioni. Sot është shumë e rëndë për shtetet që të vendosin kontrollë ndaj kriminalitetit. Shtete të caktuara marrin masa përforcuese për uljen e këtij rreziku. Një nga masat është ritja e institucioneve shtetërore, megjithatë dallimi është se veprojnë tek pasojat, e jo në parandalimin e shkaqëve. Pothuajse në të gjitha shoqëritë ekzistojnë zona të sigurta, respektivisht vende ku njerëzit ndjehen të sigurtë nga kontrolli që ekziston aty.

Shoqëria bashkëkohore, qëi bart të gjitha epitetet demokratike dhe civilizuese, me afirmim të theksuar të vlerave njerëzore dhe me tendencë të krijimit të kushteve humane për jetesë dhe respektim të lirive të njeriut, jeton me kontradiktat personale, respektivisht në rrjedhje progresive të uljes sasiore dhe zbutjes cilësore të dhunës e cila është në rritje të vazhdueshme.

Teza sipas së cilës bota e sotme ka më pak dhunë, se zhvillimii qytetërimit në vetvete sjell në ulje të dhunës, se sigurimii të drejtave dhe lirive të njeriut në vetvete cojnë në ulje të kriminalitetit është e papranueshme, sepse hulumtimet tregojnë që krimi është në ritje. I pamohueshëm është fakti se njeriu modern jeton në një botë të dhunshme e cila dhunë është më masovike, më e shpeshtë, dhe më brutale se kurrë.

Në dekadën e fundit të shekullit 20 dhe fillimin e shekullit 21, kemi periudhën ku terrori dhe krimi i organizuar është në ekspansion të vazhdueshëm në gjithë botën. Në këtë periudhë sipas praktikës dhe asaj që njohim nga literature kemi në vazhdimësi procese të ndryshimeve të shpejta sidomos në aspekt të metodave, mjeteve dhe mënyrave të organizimit dhe kryerjes së veprave penale.

Kriminaliteti i organizuar nuk njihet asnjë lloj kufiri. Organizatat kriminale të këtij lloji mundohen të integrohen në institucionet dhe në sistemin aktual që në njëfarë mënyre kanë aktivitet tregtar. Këto organizata ushtrojnë forma të ndryshme të ndikimit që ti kenë nën kontroll

zyrtarët e organeve dhe institucioneve shtetërore që janë përgjegjës për dhënien e lejeve të caktuara, të cilat e diktojnë politikën tregtare dhe janë vendim marëse për kontratat e larta tregtare. Këtë e bëjnë në atë mënyrë që vendosin njerëzit e tyre në organet më të larta të pushtetit, me korumpimin e zyrtarëve të ndryshëm.

Në kushtet moderne rrezikshmëria nga ky lloj kriminaliteti është në nivelet më të larta në të gjitha sferat e shoqërisë dhe pothuajse nuk ka vend që nuk është i infektuar nga llojet dhe format e ndryshme të kriminalitetit. Pjesëmarrësit përdorin të gjitha mjetet nga format e ndryshme të kërcënimit të hapur, mito, lidhjet politike dhe format tjera që janë nga më mizoret, kryejnë krime nga më të dhunshmet duke i shkakuar dëme të mëdha dhe të riparueshme të shoqërive konkrete po edhe të bashkësisë ndërkombëtare në tërësi.

Vëmendje të mëdha në shoqërinë tonë dhe tek skena politike zuren bisedat e përgjuara ose të ashtuquajturat ‘bomba,, të cilat u shfaqën nga ana e opozitës në atë kohë duke filluar nga viti 2015. Për këtë arsye dhe për shkak të rëndësisë së kësaj teme vendosëm ti shfaqim detajet dhe procedurën complete të rrjedhjes së këtij rasti i cili u ndajtë për publikun. Gjatë kësaj kohe u formua edhe Prokuroria Speciale Publike.

PSP u formua si rezultat i marrëveshjeve politike në kohë vërtet të rënda përMaqedoninë atëhere kur besueshmëria e qytetarëve në sistemin gjyqësor ishte në nivel shumë të ulët. Edhe pse u ballafaqua me shumë sfida që në fillim të punës së saj, arriti në rezultate të jashtëzakonshme. Sundimi i ligjit nënkupton që ligjet vlejné njëlloj për të gjithë, dhe secili që do të shkel ligjet do të përgjigjet, pa marr parasysh bindjeve dhe funksioneve politike të mëparshme, të tashme apo të ardhshme.

II. Lënda e hulumtimit

Lënda themelore e punimit te magjistraturës mbulon një zonë të caktuar si pjesë e krimit të organizuar dhe veprave kriminale në këto hapësira në pjesën e ndjekjeve të komunikimit, me theks të vecantë bisedat e përgjuara prej vitit 2014-2018, e gjitha me qëllim të zgjedhjes së problematikës në fjalë.

Lënda në kuadër të hulumtimit është e drejtuar drejt:

- Organizimii grupit kriminal për kryerje të vepës penale
- Raportet kierarkike në grup qëia mundësojnë udhëheqësit ta kontrollojë

- Dhuna, friga dhe korupsioni si mjet i përfitimit të profitit ose dobive tjera me qëllim të kontrollimit të teritoreve dhe tregjeve
- Aftësia për ekspansion nëçdo lloj aktiviteti brenda kufijve shtetërorë
- Bashkëpunim me grupe tjera kriminale të organizuara
- Raste të ndjekjes së komunikimeve nga ana e opozitës ndaj grupeve të analizuara paraprakisht, para së gjithash politikan të cilët janë në pushtet si dhe persona publik me ndikim në politikë me qëllim të argumentimit së të njejtit janë të përfshirë në grupe të organizuara kriminale/individë, ku planifikohet ose është kryer vepër penale

III. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimii këtij punimi seminarik është që ta definojmë, analizojmë dhe sqarojmë termin në raport me krimin e organizuar dhe veprat penale, si dhe strukturën dhe dinamikën e tyre në shtetin tone, si dhe kërcënimin eventual për sigurinë dhe paqën ndërkombëtare me masat dhe aktivitetet që ndërmeren për pengimin dhe kundërzbulimin si dhe prevenimin e tyre.

Në këtë mënyrë hyjmë thellë në vetë qëllimin e këtij punimi të magjistraturës, siç është rasti i ndjekjes së përgjimeve, me të cilin u njoftua masa e gjërë, por edhe më gjërësisht. Mundet të deklarojmë se pikërisht para katër viteve, respektivisht në vitin 2015, liderii LSDM-së nga selia partiake për here të pare i bëri publike inçizimet, të ashtuquajturat ‘‘bombat’’. Që nga ai moment filloi edhe rënia e qëverisjes së VMRO-DMNE-së.

Në atë periudhë u publikua inçizimi i parë,i ashtuquajtur i inçizimii parë që dëgjoji publiku, ishte biseda midis vetë Z.Z dhe gazetares së Radios Evropa e Lirë, pastaj biseda në mesë tij dhe vajzës së tij, si dhe biseda ndërmjet ministrave të atëhershëm Jankulovska dhe Stavrevski.

Z.Z në atë kohë zbuloi se janë përgjuar më shumë se 20.000 qytetarë, në mesin e të cilëve edhe gazetarë, funksionarë qëveritar, por edhe presidenti Gj.I. LSDM së shpejti pas publikimit të bombës së parë, bëri padi penale kundër ish drejtorit të policies sekrete, Sasho Mijallkov, kundër ish udhëheqësit të Drejtorisë të Pestë në MPB, G.G si dhe kundër personave të panjohur nëDSK.

Këto bomba ishin arsyeja primare për formimin e PSP, respektivisht Prokurori publike për ndjekje të veprave penale të cilat kanë lidhje ose dalin nga përmbajtja e përgjimeve të paligjshme, e cila udhëhiqët nga prokurorja Katica Janeva dhe 12 prokurorë tjerë plotësues.

Qëllimi ynë në këtë punim është që ti prezentojmë dhe analizojmë bisedat e përgjuara si pjesë e krimit të organizuar, prapavija e tyre antiligjore, supozimi për procedurën dhe mënyrën e incizimit si dhe prezentimin e përgjimeve para opinionit public, por edhe procedurat që pasuan më vonë si dhe rrjedha e mëvonshme e ngjarjeve.

Pastaj zbulohen vetë procedurat e veprimit të cilat ndërmeren në shtetin tonë, sipas rregullave dhe akteve ligjore.

IV. Hipoteza

Në suazat e hipotezës së përgjithshme gjatë hulumtimit vjen deri te domosdoshmëria e marrjes së disa masave dhe aktiviteteve të caktuara të cilat janë pjesë përbërëse ndaj mbrojtjes prej krimit të organizuar dhe bandave kriminale, si dhe ndërmarja e masave dhe aktiviteteve të caktuara për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale nëpërmjet procedurës së ndjekjes së komunikimit që i ndërlidh organizatat kriminale në brendësi gjatë marrëveshjeve për kryerje të veprave të caktuara penale. Si edhe ndërtimi i besueshmërisë midis shteteve dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në gjithë rajonin, është e një rëndësie të vecantë në perceptimin e sigurisë kombëtare të secilit shtet si dhe aktiviteteve të ndërmara në mbrojtjen e tyre.

Që të kryhet ndjekja e komunikimeve është e nevojshme leja e gjykatës përkatëse për ndjekje të komunikimit, përveç në rastet kur ekziston pëlqim i personave të cilët janë të përfshirë në komunikim. Ndjekja e komunikimit kryhet në kushte të përcaktuara qartë me Ligjin për ndjekje të komunikimit dhe Ligjin e procedurës penale, edhe atë në mënyra dhe procedura të cilat nuk i kërcënojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Të dhënat dhe informatat e mbledhura nëpërmjet ndjekjes së komunikimit, varësisht mënyrës se si janë mbledhur mund të përdoren kundër individit/personave që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprave penale me qëllim të dëshmimit të përgjegjësisë së tyre (ose pafajshmërisë) deri sa nuk dëshmohet e kundërta para gjykatës së drejtësisë.

HIPOTEZA E PËRGJITHSHME

Në kuadër të hipotezës së përgjithshme gjatë hetimit paraqitet - „domosdoshmëria për ndërmarjen e masave dhe aktiviteteve të caktuara të cilat janë pjesë përbërëse për mbrojtje nga

krimi i organizuar dhe bandat kriminale, si dhe marjen e masave dhe aktivitetëve të caktuara për shkatërimin e tyre dhe zbulimin e veprave penale nëpërmjet procedurës së ndjekjes së komunikimeve të cilat i lidhin organizatat kriminale ndërmjet veti dhe përbrenda gjatë negociatave për kryerjen e vepërës së caktuar penale. Si dhe krijimit të besimit në mesë të shteteve dhe bashkëpunimit të tyre të përbashkët në raport me tërë regjionin, dhe ndikon në mënyrë të ndjeshme në perceptimin e sigurisë kombëtare të secilit shtet si dhe të aktivitetëve të ndërmara me qëllim që ajo të mbrohet” – kjo hipotezë vërtetohet me qëndrimin e shprehur në tekstin e mëtutjeshëm.

Për shkakë se trendet, pasojat dhe vlerësimet e ditëve të sotme për krimin e organizuar dhe terorizmin në të ardhmen shpeshëherë sjellin deri te përfundime alarmante, lufta kundër këtyre fenomeneve fitoi prioritet jo vetëm nga perspektiva evropjane por edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Duke marrë parasyshë vlerën e vlerësimeve të sotme, terorizmi dhe krimi i organizuar në të gjitha format e saja edhe në të ardhmën e afërt do të paraqet kërcënim serioz. Ritja e terorizmit islamik, terorizmi etniko-separatist, si dhe lidhja në mesë të terorizmit dhe krimit të organizuar, i detyroi shtetet që të risin përpjekjet që të mundë në mënyrë sa më efektive të përballen me çështjet dhe problemet e drejtëpërdrejta të cilat i shkaktojnë këto dy fenomene. Përpjekjet tilla kanë rezultuar me marrëveshje bilaterale dhe multilaterale ndërmjet shteteve të interesuara, me të cilën ndërmeren masa për parandalimin e ritjes së krimit të organizuar dhe aktivitetëve teroriste. Trendi tjetër i rëndësishëm është edhe qëllimi i përherëshëm për vendosjen e bashkëpunimit të ngushtë në mesë të shërbimeve sekrete me qëllim të shkëmbimit të informatave të kundërzbulimit.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i vendosur zhvillohet sipas hapave si në vijim:

- Të ekzistoj „shkëmbimi i rregulltë i informatave,, në mesë të ekspertëve për luftën kundër terorizmit dhe krimit të organizuar;
- Vendosja e ligjeve dhe rregullavetë përbashkëta antiteroriste me qëllim që në luftën kundër terorizmit dhe aktivitetëve kriminale të ekzistoj qasje e përbashkë;
- Formimin e bazës së të dhënave;
- Edukimin e publikut që të mundë të kuptojë kërcënimin nga krimi i organizuar mbi proceset demokratike;

- Zhvillimin e kulturës sociale e cila nuk e toleron prezencën e krimit të organizuar. Të dhënat tregojnë se kur qeveria dhe populli e refuzojnë ndikimin e krimit të organizuar, grupet e organizuara nuk mundë të mbijetojnë.¹

Në këtë tekst, disa elemente janë thelbësore, siç janë:

- Pavarësia e gjyqësorit;
- Kufizimi i imunitetit parlamentar;
- Transparenca e akteve qeveritare;
- Bashkëpunimi në mes të agjensioneve të ndryshme kombëtare, fushëveprimi i së cilave është lufta kundër krimit të organizuar;
- Trajnim adekuat të nivelit të lartë për ata të cilët luftojnë kundër krimit të organizuar, veçanërisht sepse kriminelët gjithnjë e më shumë përdorin teknika të „sofistikuara,, dhe të specilaizuara.

HIPOTEZAT E VEÇANTA

➤ *Mbikqyerja e fshehtë dhe ndjekja e komunikimeve,*

„Që të mundë të kryet ndjekja e komunikimeve duhet leje nga gjykata përgjegjëse për të kryer ndjekjen e komunikimeve, përveç nëse i janë destinuar apo ekziston pëlqim nga personi apo personat të cilët janë përfshirë në komunikimin. Ndjekja e komunikimeve realizohet mbi kushtet e parapara me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligjin përprocedurë penale, edhe atë në mënyrën dhe procedurën me të cilën nuk kërcënohen të drejtat dhe liritë e njeriut.”- kjo hipotezë vërtetohet, me qëndrimin e shprehur në tekstin e mëtutjeshëm.

Në punimin e magjistraturës edhe më parë është paraqitur se, askushë nuk duhet që pa urdhërin e gjykatës përkatëse të kryej ndjekjen e komunikimeve, përveç nëse i janë destinuar apo akziston pëlqim nga personi apo personat të cilët janë përfshirë në komunikimin.

Ndjekja e komunikimeve realizohet mbi kushtet e parapara me *Ligjin për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligjin përprocedurë penale*, edhe atë në mënyrën dhe procedurën me të

¹Albini,J.,Hansen, P.,Sullivan,B.”Organized Crime:The National Security Dimension”,George C.Marshall European Center for Security Studies, 1999, p.p 9

cilën nuk kërcënohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Ndjekja e komunikimeve mundë të zgjatë vetëm një kohë të caktuar, e cila është e nevojshme për mbledhjen e të dhënave me qëllim të realizimit të qëllimeve të ndjekjes.

➤ *Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve dhe shfrytëzimi i tyre para gjykatës përgjegjëse.*

„Me të dhënat dhe informacionet e mbledhura nëpërmjet ndjekjes së komunikimeve, varësisht se në çfarë mënyre janë mbledhur ato mundë të përdoren kundër personit/personave të cilët kanë marë pjesë në kryerjen e veprës penale në atë rastë me qëllim dëshmimin e përgjegjësisë së tyre (apo pafajësisë) përderisa nuk dëshmohet e kundërta para gjykatës së drejtësisë”. Gjithashtu, edhe kjo hipotezë vërtetohet, me qëndrimin e shprehur në tekstin e mëtutjeshëm.

Mund të konkludojmë se informacionet dhe të dhënat të cilat janë mbledhur nëpërmjet ndjekjes së komunikimeve të personave të caktuar të cilët janë përfshirë në veprat penale edhe në përmasa më të mëdha, si krimi i organizuar përdoren në gjykatë dhe në procedurën penale kundër tyre, me qëllim dëshmimin e veprës së kryer me të cilën ngarkohen të njejt.

V. Metodologjia e hulumtimit

Gjatë hulumtimit të kryer në procesin e përpilimit të punimit, përveç shfrytëzimit të të dhënave dhe informative nga burimet e disponueshme në kohën e procesit të përgatitjes së studimit, paralelisht me qëllimin e hulumtimit, do të zbatohen metodat e mëposhtme, me qëllim që të fitohen konkluzione më të forta dhe valide që janë në lidhshmëri me kornizat e hipotezave të lartë përmendura:

- Metodatat – Analitike – Sintetike – analiza e fenomeneve të caktuara, shqyrtimi i komponentëve të tyre përbërës, duke analizuar strukturën e brendshme të krimit, përbërjen, formën në të cilën e njejta paraqitet, veçoritë dhe karakteristikat, me qëllim të definimit dhe sqarimit të lehtë të termit krimi i organizuar dhe veprat penale në një shtet;

- Metoda – Induktive – Deduktive, hulumtim empirik, ndjekje dhe analizë e dukurive dhe formave të krimit si një fenomen real shoqëror, paraqitje negative, duke aplikuar qëndrime të caktuara, përfitimi i përfundimeve të caktuara dhe në të kundërtën e përfundimeve të

përgjithshme, me anë të deduksionit, me bashkim të tyre, analizë, të vihet në një përfundim për fenomenin negative shoqëro

- Metoda statistikore – në menyrë statistikore do të përpunohen të dhënat e grumbulluara, të njejtat do të interpretohen dhe analizohen, në bazë të së cilës do të sillen konkluzione të caktuara për fenomenin e kriminalitetit, si dhe aktivitetet e shërbimeve në raport me ndjekjen e komunikimeve dhe ndikimet ndaj saj.

- Metoda e deskriptimit – si procedurë për përshkrimin dhe përcaktimin e lëndës në punim shkencor me sqarim dhe komentim shkencor. Gjatë deskriptimit shfrytëzohet më shumë literaturë shkencore dhe hulumtime konkrete nga ekspert të njohur, shoqata profesionale ose institucione relevante nga vendi, por edhe të jashtme;

- Analiza e përmbajtjes së dokumenteve (content analysis) – analizë e librave shkencorë, doracakë, artikuj, raporte, dokumente zyrtare, në të cilat sqarohen aktivitetet e shërbimeve sekrete në raport me pengimin dhe shkatërimin e krimit të organizuar, me qëllim të depërtimit të thellë në metodologjinë dhe shkakut të paraqitjes si dhe shuarjen e saj;

- Metoda e studimit të rastit – analizë e rasteve dhe fenomeneve të caktuara të krimit të organizuar dhe veprave të ndryshme penale dhe shuarja e tyre, me prezentimin e rasteve individuale, si dhe rasti i ndjekjes së komunikimit – bisedave të përgjuara, me të cilat do të shihen më mirë rastet, si dhe faktorët që ndikojnë në aktivitetet e ndërmara dhe sukcesi i tyre në fund.

Gjatë hulumtimit metodologjik do të shfrytëzohet bazë e konsiderueshme informative e të dhënave dhe informative midis të cilave janë edhe aktet normative, hulumtimet dhe qëndrimet shkencore të organeve të specializuara me autorizim për lëminë e problematikës së hulumtuar.

KAPITULLI I-rë

1. Kuptimi për krimin e organizuar dhe veprat penale

1.1 Kuptimi për „krimin e organizuar”

Krimi i organizuar, si dukuri kriminale paraqet problematikën më kontraverse të ditëve të sotme, një ndër dukuritë më komplekse nëqënien e saj. Ndërlikueshmëria e saj gjatë përcaktimit të karakteristikave të saj, më saktësisht kundërshtitë në krimin e organizuar paraqiten në karakterin transcendental. Kushtimisht thënë, shumë prej veprave penale mund të reshtohen në fushën e krimit të organizuar përderisa i kanë elementet e definicioneve ligjore të krimit të organizuar. Për definimin e krimit të organizuar, në literaturë egzistojnë definicione të shumta.

Duke pasur parasysh që krimii organizuar është një fenomen i ri akoma egzistojnë vështirësi në përcaktimin e problemeve më të rëndësishme teorike që lidhen me zbulimin e tij, vërtetimin, sqarimin dhe parandalimin. Duket se në lidhje me këtë, praktika kriminale është para teorisë², edhe atë për një arsye të thjeshtë pasi që akoma nuk janë krijuar sisteme teorike dhe nënsisteme në nivele të dijeve të metodikave kriminale në luftë kundër çfardo lloji të grupeve kriminale në lëminë e krimit të organizuar. Ky process është në rrjedhë dhe ështëi determinuar nga studimi më afatgjatëi fenomenologjisë së pasur kriminale të këtij fenomeni, si një nga problemet kyce në ndërtimin e strukturës së luftës kriminale-metodike në frontin e gjërë.³

Ashtu sic ekzistojnë kundërshtime, si dhe qëndrime të kundërta, në aspekt të definimit të kriminalitetit në tërësi, kjo pyetje gjithashtu, nuk e përjashton krimin e organizuar⁴, pa dallim nëse bëhet fjalë për termin kriminal apo kriminogjen.

Me termin krim i organizuar nënkuptojmë, „*ashtu grupacione me mënyrat e kryerjes së sulmeve sistematike dhe të vazhdueshme në më shumë sfera të jetës ekonomike shoqërore, nëpërmjet të cilave grupe të caktuara delikvente si dhe anëtarë të grupeve kriminale fortë të organizuar në nivele klerarkike me role të caktuara dhe respektim të pa rezervë, arrijnë*

²Grozdan Cvetkovski, *Oktopodi Maqedonas*, Silsons, Shkup, 2008.

³Po aty .

⁴Z.Stojanovic, *Format e organizuara të krimit*, Siguriadhe DSZ, Beograd, 5/1990, faq.63.

përfitime të mëdha deri tek të cilat vijnë në mënyrë të pamëshirshme dhe me përdorimin e teknikave dhe taktikave të larta profesionale’’⁵

Me definicionin e krimit të organizuar në hapësirat tona merret akademiku Vlado Kambovski. Prof Vlado Kambovski krimin e organizuar e definon si: *„Kryerjen e veprave penale nga ana e shoqatave kriminale me ëellim të realizimit të përfitimeve/ ose arritjes së fuqisë, me përdorim të dhunës, ose me shfrytëzim të pozitës në shoqëri, me zvoglimin e rrezikut me përfshirjen e ekonomisë legale, aktiviteteve politike, si dhe me sistemin paraprakisht të pregatitur për mbrojtje nga ndjekja penale.’’⁶*

- Karakteristikat e krimit të organizuar

Deklarata politike e Napolit dhe plani global për aksion kundër krimit të organizuar, më vonë të miratuara nga Shtabii Përgjithshëm i OKB, të reafirmuara në dokumentet e Kongresit të Nëntë të KB në parandalimin e krimit, Kairo viti 1995, theksohet rritja drastike e krimit të organizuar dhe u bëhet thirrje shteteve të ndjekin përvojat e shteteve tjera në zhvillimin e ligjvënien adekuat, dhe praksën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Planin global për veprim, duke pranuar që nuk egziston definicioni legal për krimin e organizuar, i thekson karakteristikat vijuese:

- Organizimii grupit për kryerjen e veprës penale
- Raportet hierarkike në grup që mundësojnë liderit të kontrollojnë grupin
- Dhunë, frikësim dhe korupsion si mjete për realizimin e përfitimeve dhe kontrollin teritoreve dhe tregjeve
- Larja e përfitimeve jolegale dhe infiltrim në ekonominë legale
- Aftësia për ekspansion në çdo lloj aktiviteti edhe jashtë kufijve kombëtarë
- Bashkëpunimi me grupe tjeratë organizuara ndërkombëtare.

Nevoja për zhvillimin e termave teorik të krimit të organizuar e imponon ndërgjegjësimin se në sferën e krimit ekziston dicka që është identike me format tjera të aktivitetit kriminal, por

⁵Zoran Ivnovski dhe Metodija Angeleski, *Sistemet e sigurisë*, Jugoreklam, Shkup, 2005, faq.71.

⁶Kambovski, V., *Shteti juridik dhe krimii organizuar*, Fakulteti juridik, Justinianii Parë, Shkup, 1996 vit.faq.8 dhe 9.

megjithate dallon, sipas mënyrës së kryerjes, aktivitetit të përbashkët të më shumë pjesëmarrësve, realizimit të rezultatit kriminal, fshehjes së aktiviteteve kriminale dhe të ngjashme, dhe se është frikësuese forca që ka.

Së dyti, niveli operacional i definicionit është lidhur me të mëparshmen dhe jep përgjigje për nevojën e aktiviteteve parandaluese konkrete si dhe aktivitetet represive të drejtuara ndaj formave të caktuara të veprave penale.

Në kuptimin e zgjeruar termi krimi i organizuar nënkupton kryerje të përbashkët të ndonjë vepre penale nga ana e më shumë personave.

Në një kuptim më të ngushtë nënkupton kryerjen e veprave penale nga ana e organizatës kriminale, (bandë, grupacion, shoqatë kriminale), e organizuar sipas parimeve të caktuara të brendshme dhe klerakisë statutoire në aktivitetet e përbashkëta kriminale që kryejnë organizatori dhe së paku dy anëtarë të grupit kriminal.

Në kuptim edhe më të ngushtë, për dallim prej elementeve të mëparshëm sasior, krimin e organizuar e definojmë si kryerje të përbashkët të veprave të dënueshme për qëllim të arritjes së përfitimeve ekonomike dhe politike.

Secila nga tre definicionet ka domethënien e saj, si nga aspekti shkencor për hulumtimin dhe ndjekjen e dukurive të tilla të definuara, ashtu edhe imlementimi i tyre praktik dhe ligjor. Ashtu, ndarja e vecantë e krimit të organizuar në kuptimin më të zgjeruar dhe theksimi i kumulimit në energji kriminale ku gjatë kryerjes së veprës vepra penale rritet në progresion aritmetik paraqet bazë për trajtimin e veçantë juridik për pjesëmarrje.

Definicioni i krimit të organizuar në kuptim më të ngushtë e kombinon metodën deskriptive dhe metodën e mjetit dhe qëllimit. Ashtu, p.sh. Shuler Springorum me këtë term i mbulon aktet e mëposhtme:

- Vjedhja, transporti dhe tregtia e paligjshme me mjete motorike
- Shantazh dhe grabitje, në vecanti të orientuara në restorante, bare dhe të ngjashme,
- Tregti ndërkombëtare me lëndë narkotike,
- Krijimii kompanive të rejshe dhe shoqata, në vecanti për larjen e parave,
- Tregtia me njerëz me qëllim të prostituimit,
- Mito dhe korupsion,
- Tregtia ilegale me armë.

Kajzeri⁷ e përcakton këtë term nëpërmes disa indikatorëve: shoqërim i fshehtë i më shumë personave të orientuar në shoqata fitimprurëse, struktura organizative, veprim sipas planeve dhe ndarja e obligimeve, lidhja e punëve joilegale me punët legale, teknologji fleksibile kriminale dhe zgjedhje e metodave të dhunshme, shfytëzim infrasrukturës radio-telefonike dhe infrastrukturë tjetër mobile dhe ndërkombëtare. Karakteristikë e vecantë është tentimi për ndikim mbi politikën, mediumet, administratën publike, sitemin gjyqësor dhe tregtar. Për dallim nga format tjera tradicionale të kriminalitetit grupor, krimi i organizuar karakterizohet me më shumë se tre vecori të lart përmendura. Përndryshe, qasja e Ginter Kajserit është definicion shumë i qëlluar, duke pasur parasysh se kjo qasje e definimit është e kontrolluar për identifikimin e formave të ndryshme të organizuara të tipit mafioz të krimit të organizuar dhe krimit të organizuar grupor në shoqëritë e ndryshme.

Termi *krim i i organizuar institucional (politik)* është term i ri teorik, i cili implikon shumë konsekuenca konkrete dhe praktike në luftën kundër krimit të organizuar, me karakteristika specifike në vende të ndryshme. Nga gjithë këto definicione mund të sublimojmë një të vetmen, e ajo është se krimi i organizuar nënkupton kryerjen e veprave të dënueshme nga ana e grupeve kriminale me qëllim të përfitimit të fuqisë dhe profitit, me përdorim të dhunës dhe pozitës së vecantë në shoqëri, me zvoglimin e rrezikut duke u kycur në aktivitete legale ekonomike, politike si dhe aktivitete tjera me sistem të rregulluar të mbrojtjes nga ndjekja që më herët.

Definicioni i parashtruar i përmban elementet në vijim:

- ***Vepra të dënueshme:*** vrasje, lëndime fizike dhe dhunë tjetër ndaj jetës dhe trupit, vjedhje, grabitje, mashtrim, zhvatje dhe shantazh, mashtrim i konsumatorëve, mashtrim me siguracione, mashtrim gjatë ndarjes së kredive, mashtrim tek tregtimi me aksione, falsifikimi i parave, evazioni fiskal, larja e parave, kontrabanda dhe tregtia e paligjshme, prostitucioni, trafikimi i qënieve njerëzore, vepra që kanë lidhje me drogën, tregtia me armë, me material toksik dhe radioaktiv, vepra kundër shtetit, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, mito dhe korupsion, vepra në turmë, falsifikimi i dokumenteve, terrorizëm ndërkombëtar dhe vepra tjera ndërkombëtare.
- ***Organizimi:*** bandë, grup ose formë tjetër shoqërimi në aktivitetet e të koordinuara të cilave marrin pjesë së paku tre veta, ku njëri luan rolin e organizatorit ose udhëheqësit.

⁷V.Ginter Kajzer, Kriminologjia, Shkup 1996, faq.195.

- **Realizimi i përfitimit ose fuqisë:** përfitimi dhe fuqia janë në bashkim të ndërsjelltë, ashtuqë përfitimi përfaqëson bazën materiale për fuqinë politike ose fuqi tjetër, derisa fuqia e ndikimit në ekonomi, politikë dhe në fushat tjera është parakusht për përfitim sa më të madh.
- **Mjete:** dhuna përfaqëson mjetin e fundit, por jo edhe mjet përjashtues për arritjen e qëllimit, atëherë kur pozita e vecantë, në politikë ose në pushtet nuk i jep rezultatet e pritshme.
- **Zvogëlimi i rrezikut:** Lidhshmëria e aktivitetit kriminal në sferat legale të biznesit, financave, sitemin bankar, politik, në funksionet e organeve shtetërore dhe fushat tjera shoqërore të ndikimit pasi që është mënyra më efikase e eliminimit të riskut nga zbulimi dhe ndjekja, pasi që konfuzionii përgjithshëmi i së lejuarës dhe së ndaluarës con kah bllokimi i fuqisë rregulativës për dënim dhe drejtësi.
- **Sistemi i mbrojtjes:** sistemi formal i mbrojtjes nënkupton ndihmën dhe lejimin e aktiviteteve kriminale nga ana e organeve shtetërore, ose në bllokimin e organeve në ndjekjen dhe vendosjen e drejtësisë me anë të rrugës së korupsionit me qëllim mbrojtjen dhe tolerimin a aktiviteteve kriminale për shkak të dobisë ekonomike dhe politike, përderisa sistemi joformal përfaqëson formën e vetëorganizimit të nëntokës kriminale përballë sistemit të drejtësisë kriminogjene.

1.2 Analiza e karakteristikave të krimit të organizuar modern

1.2.1 Problemet gjatë të kuptuarit të krimit të organizuar

Sot termi krimi i organizuar nuk është ka përcaktim unik. Për të ekzistojnë një numër i madh definicionesh të cilat kanë dallimë thelbësore dhe jothelbësore.⁸

Ndoshta problemi më i madh në të kuptuarit e krimit të organizuar nuk është fjala krimi, por fjala e organizuar. Në fakt, edhe pse publiku, kriminologët dhe literatura hulumtuese shpeshherë pajtohen për elementet e sjelljes kriminale, nuk ka pajtim të plotë rreth asaj se çka e përbën aktivitetin e organizuar kriminal. Për ilustrim do të japim disa shembuj.

⁸Kambovski Vllado, Krimii organizuar, 2 Gusht, Shtip, 2005, faq.31-41.

Kështu p.sh të supozojmë se ekziston një grup hajnash të cilët në mënyrë sistematike vjedhin vjedhin mall në një shitore e caktuar. Pyetjen të cilën do ta kishim vendosur në kontekst të krimit të organizuar është se a mundet të pranohet pohimi që ky grup hajnash përfaqëson shembull të krimit të organizuar?

Ose të japim edhe një shembull tjetër, a konsiderohet krim i organizuar seria e vrasjeve të kryera nga dy vrasës psikopatë në kohëzgjatje prej tre muajsh? Më tej një vjedhje e mirë organizuar e një banke ku marrin pjesë, vjedhës profesional i automjeteve i cili do të organizojë mjetin për ikje, shofer i cili do të vozitë, dhe personi përgjegjës për lirimin e të hollave të vjedhura janë shembull i krimit të organizuar.

Nga shembujt e prezentuar mund të konkludojmë se të njëjtat nuk janë shembuj të krimit të organizuar, por janë shembuj ku egziston procedurë e menduar për kryerjen e krimit me qëllim eksplicit për ti i kur zbulimit.

Njëri nga autorët më referent për definimin e krimit të organizuar Ginter Kajzer, jep një hyrje më të zgjeruar drejt definimit të organizuar.⁹ Ai thekson se për të egzistuar krimi i organizuar duhet të ekziston:

- Bashkime të përhershmetë më shumë personave si bashkësi solidare e orientuar në grup interesi dhe fitimprurëse,
- Strukturë e organizuar që, në njërin anë, karakterizohet me stiltë ashpër të udhëheqjes, disiplinë e anëtarëve, por edhe kujdes për sigurinë e tyre, ose, nga ana tjetër, rrjet i shkelësve të veprave penale me ‘‘stil të lirshëm’’ të udhëheqjes,
- Trajtim sipas planit dhe ndarja e punës,
- Lidhja e punëve legale me ato jolegale në përputhshmëri me nevojat e duhura të popullatës, shfrytëzim kriminal i lidhjeve personale afariste
- Teknologji fleksibile të dhunshme dhe paletë e pasur e metodave të dhunës (si eksploatim, kërcënim, dhunë, mbrojtja e detyrueshme, terror, deri në rryshfet aktiv) ku dhuna ndaj personave përjashton favorin dhe shtypjen e të gjitha llojeve.

⁹KajzerGinter, Aleksandrija, Kriminologjia, Shkup 1996, faq.194.

- Shfrytëzim i qëllimshëm i infrastrukturës (lidhjet radio telefonike, mjetet ndërkombëtare transportuese) dhe
- Lëvizshmërinë ndërkombëtare.

1.2.2 Ridefinimi i krimit të organizuar nën ndikimin e trendeve modern

Kuptimet tradicionale për strukturën, atributet dhe karakteristikat e krimit të organizuar sfidohen seriozisht nga ndryshimet ekonomike, politike dhe shoqërore.

Globalizimi ekonomik botëror, zvogëlimi i ndikimit të shteteve – kombe dhe suverenitetit nacional, bashkë me zgjerimin e rrjeteve komunikative dhe medimeve luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin, atributet dhe karakteristikat e krimit të organizuar

Sociologja Italiane Leticija Paoli, (e cila ka bërë një nga hulumtimet më të rëndësishme për krimin e organizuar), sugjeron se globalizimi i tregjeve ndërkombëtare është në kundërshtim me organizatat e mëdha klerkike, sic janë Mafia italiane, Xhakuza, apo Trijadat kineze. Paoli konstaton se këta forma tradicionale të organizimit në mënyrë serioze e pengojnë pjesëmarrjen e suksesshme në tregjet globale. Ajo konsideron që këta organizata, struktura e të cilave shpeshherë mbështetet në lidhjet shoqërore, e jo në dinamikën e tregut, nuk janë më aq struktura efektive ku mbështetet krimi i organizuar.¹⁰

Qëndrimin e tillë e forcon Manuel Kastels i cili beson se në botën e tregut global dhe komunikimeve aktuale, organizatat me rrjet më të vogël bëhen normë për aktivitetin legjitim dhe jolegitim. Kastelas thekson:

„Mundësitë organizative dhe teknologjike për formimin e rrjeteve globale e kanë transformuar dhe i kanë dhënë forcë krimit të organizuar. Startegjia e tyre fundamentale një kohë të gjatë ka nënkuptuar depërtimin në institucionet lokale dhe shtetërore në shtetin amë dhe mbrojtjen e aktivitetiteve të saj. Ajo edhe më tej është një element i rëndësishëm në procedurat operative të krimit të organizuar: mund të ekzistojë vetëm mbi bazë të korupsionit dhe frikësimit të personelit shtetëror, e ndonjëherë edhe të institucioneve shtetërore. Por kohëve të fundit globalizimi ka shtuar edhe një moment vendimtar në strategjinë institucionale të krimit të organizuar, lëvizshmërinë e madhe dhe fleksibilitetin ekstrem të rrjeteve, që u mundëson

¹⁰Paoli Letizia, The paradoxes of Organized Crime, Crime Law and Social Change, Vol.37, NO-1, 2002, faq.51-97.

anëtarëve të grupeve të krimit të organizuar tu ikin rregullave nacionale dhe procedurave rigide të bashkëpunimit ndërkombëtar të policisë”.¹¹

Përgjegjësia primare e shërbimit kombëtar për zbulime kriminale (NCIS) e Mbretërisë së Bashkuar i referohet analizës së të dhënave për kundërzbulim për krimin e organizuar. Ky shërbim (NCIS 2005) sqaron se krimii organizuar i ka këto katër attribute:

1. Grup i organizuar kriminal që përbëhet nga sëpaku tre persona,
2. Aktiviteti kriminal i grupit është i vazhdueshëm dhe me afat të pacaktuar,
3. Grupi është i motivuar me dëshirën për përfitim dhe fuqi, dhe
4. Grupi kryen shkelje serioze kriminale.

Ky këndvështrim për krimin e organizuar ka dallim drastik nga ajo që tradicionalisht përdoret nga institucionet për sundimin e ligjit anembanë botës. Por, qëndrimi i këtillë i reflekton realitetet e tregut të ndryshueshëm jashtëligjor.¹²

Tabela 1. Manifestimet jo shumë të largëta të aktiviteteve të krimit të organizuar tradicional

Aktivitete burimore	Verzioni global
Numrii rreziqeve nga mashtrimi në nivel lokal	Mashtrimet në internetit të veb-faqeve ndërkombëtare
Tregëtia me kokain dhe heroin	Barnat sintetike (p.sh. metamfetamina, ekstaza – drogat të cilat janë gjithmon të kapshme)
Prostitucioni rrugor	Prostitucioni në internetë dhe tregëtia me njerëz
Shantazh për „mbrojtjen,, e sipërmarrësve lokal	Shantazhindaj sipërmarrësve të mëdhenjë, korporatave dhe kidnapimii drejtorëve
Zhvatja	Larja e parave, gurrëve të shtrenjtë dhe mallrave të tjera me vlerë
Mbrojtja e pronës së vjedhur	Vjedhja e pronës intelektuale, falsifikimii CD-ve, softverëve, DVD-ve

Albaneze (Albanese, 2005) pretendon se krimi i organizuar tradicional ka ndryshuar vitet e fundit.¹³ Në të vërtetë, autori sqaron se në pikëpamje historike krimii organizuar më së shpeshti

¹¹Castels 1998: 202, E parë në: Michael D Lyman and Gary W. Potter, Organized Crime, Fourth edition, Pearson Education, 2007, faq.5.

¹²Michael D Lyman and Gary W. Potter, Organized Crime, Fourth edition, Pearson Education, 2007, faq.7.

realizohet në nivelin lokal, me çka natyra e aktiviteteve të tyre egërsisht ka ndryshuar. Në tabelën 1, autori i ka prezantuar ndryshimet e lartë përmendura të natyrës së krimit të organizuar.

1.3 Kushte për veprimin e krimit të organizuar

Në dy dekadat e fundit, qeveritë dhe qytetarët e më shumë shteteve shprehin shqetësime lidhur me kërcënimin në rritje të kriminalitetit.

Edhe pse llojet e ndryshme të kriminalitetit dhe sundimi i tij në masë të madhe është me karakter lokal, mediumet e shtypura dhe elektronike e theksojnë komponentën transnacionale të tregtisë së drogës, punës antiligjore, tregtisë me njerëz, mashtrimeve dhe terrorizmit, dhe mendohet që vendi i veprimit kundër këtyre dukurive është në tregjet politike ndërkombëtare, në planin rajonal dhe global.

Një tregues i këtij interesi është fakti që në dy dekadat e kaluara Kombet e Bashkuara i kanë kushtuar katër konventa çështjeve lidhur me krimin e rëndë.

Pas sulmeve të 11 Shtatorit që ndodhën në SHBA dhe bombardimeve të njëpasnjëshme më pak drastike në Afrikë, Azi dhe Europë duket se kërcënimi që vjen prej krimit të organizuar nisi të zvogëlohet në qarqet zyrtare dhe u zëvendësua me atë të terrorizmit, i cili pjesërisht financohet prej krimit, që solli deri te formimii frazave emotive si narko-kriminal.

Nivelet e organizimit të veprave kriminale në secilën shoqëri janë nën ndikimin e kontrollave, pa dallim nga ajo sa rreptësisht kryhen ato, ashtuqë ky shqyrtim i thjeshtë është kontributi më i rëndësishëm në perspektivat ndërvepruese në kriminologji dhe paraqësin porosinë e fshehur për aktivitetet rutinore dhe modelet e preventimit të krimit momental.

Termi krimi i organizuar nuk nënkupton vetëm një tërësi pjesëmarësish por edhe një tërësi të aktiviteteve kriminale.

Në kohët e sotme, aktivitetet fitimprurëse përfshijnë tregtinë me drogë, tregtinë me qenie njerëzore, reketimin, kidnapimin me qëllim të përfitimit, hedhje e paligjshme e mbeturinave toksike (krim ekonomik), mashtrime të sofistikuar me kartela kreditore, mashtrime të drejtuara

¹³Albanese, J.S. (2005). North American Organized Crime. Global Crime Today. Ed. M. Galeotti. New York: Routledge.

kundër UE-së, kontrabandë me qëllim të ikjes së tatimit të akcizave për alkool dhe duhan, vjedhje të pronës intelektuale (audio dhe video pirateri dhe falsifikim i prodhimeve të ndryshme), ikaj nga pagesa e TVSH , korrupsion dhe të tjera.

1.4 Dimensionet globale të krimit të organizuar

Krimi i organizuar përfaqëson një sfidë serioze për sigurinë nacionale dhe në përgjithësi për interesat ndërkombëtare. Në analizën e fenomenit për krimin e organizuar duhet të kemi qasje objective dhe studimore, pa emocione dhe zmadhim të vëllimit të kërcënimeve të saj për stabilitetin e shteteve. Prej një rëndësie të vecantë për një analizë të këtillë është të kuptohet dhe të ‘matet’ natyra e vërtetë dhe përmbajtja e kërcënimeve të këtilla.¹⁴

Pasuria dhe forca e organizatave kriminale individuale rritet dhe lidhjet e tyre ndërkombëtare midis organizatave kriminale janë sa më të dukshme. Organizatat kriminale në përgjithësi merren me biznese dhe në këtë kontekst janë të ngjashme me kompanitë legale, respektivisht aktivitetet e tyre zhvillohen në kushtet e konkurrencës dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë.¹⁵

Organizatrat kriminale nuk janë fenomen i ri. Në histori ekzistojnë shembuj të shumtë të organizimit të nëntokës kriminale. Gjithashtu, nuk është risi edhe komponenta etnike e organizatave të tilla, si për shembull mafia siciliane, kineze, shqiptare dhe të tjera, shumica e tyre e kanë edhe dimensionin ndërkombëtar.

Megjithatë ekziston diçka specifike në kërcënimet që kanë organizatat e këtilla ndaj shoqërive të organizuara, ashtuqë me rëndësi esenciale është definimii volumit dhe natyrës së problemit.¹⁶ Është e rëndësishme që në mënyrë të drejtë të definohet termi ‘organizata kriminale’, të sqarohet se nga cilat aktivitete dallojnë organizatat e thjeshta nga ato kriminale, nga ndërmarjet e biznesit ose aktivitetet e nëntokës apo ekonomitë joformale

¹⁴Magnus Hornqvist, Risk Assessments and Public Order Disturbances: New European Guidelines for the Use of Force?, *Journal of Scandinavian Studies in Criminology and Crime Prevention*, vol 5, 2004, faq. 4-26.

¹⁵Christie N. *Crime control as industry*, London & New York: Routledge, 1994.

¹⁶Crawford A., The Governance of Crime and Insecurity in an Anxious Age, in Crawford (ed.). *Crime and insecurity*, Devon: Willan, 2002.

1.5 Veprat penale dhe definimi i tyre në aspektin juridik

Definimii termit “vepër penale” nuk është punë e thjeshtë pasi që ekzistojnë qasje të ndryshme për përcaktim. Kështu definicionet e tyre për këtë term japin jo vetëm jurist por edhe sociologë, psikologë, dhe kategori tjerë të njerëzve të cilët meren me problematikën juridiko penale.

Megjithatë ajo që na intereson është definimi i termit “vepër penale” nga aspekti juridik. Në teorinë e së drejtës penale hasen më shumë mendime për përcaktimin e termit “vepër penale” të cilat mund të ndahen në dy grupe themelore: definicione formale dhe material.

Definicionet formale janë më shumë të drejtuara ka forma, respektivisht ana e jashtme e dukurisë, përderisa definicionet materiale janë të drejtuara kah thelbi.

Në anën tjetër ekziston ndarja edhe Brenda definicionit formal të termit “vepër penale”. Ashtuqë hasen termi normative dhe realist i termit vepër penale. Sipas qasjes normative vepra penale përcaktohet si: “fenomen juridik i cili shkakton pasoja të caktuara juridike”. Në anën tjetër termi realist e përcakton si “vepra penale është ngjarje reale në botën e jashtme që paraqitet si sjellje e palejueshme”. Në bazë të këtyre termave nxjeret definicioni formal për veprën penale: “sjellje të njeriut të cilën ligji e përcakton si vepër penale ku parashihet dënim ose sanksion tjetër për kryersin e saj”.

Vërehet që përcaktimit të këtillëi mungon qasje e mirëfilltë, nuk preket përmbajtja e saj material, domethënia e saj sociale, respektivisht arsyet e mosmiratimit të saj nga shoqëria.

Për tejkalimin e kësaj situatë shfaqët definicioni material për termin “vepër penale”. Sipas saj, vepra penale përfaqëson sjellje të rrezikshme, respektivisht është sjellje e cila rrezikon rendin shoqëror dhe jetën e përbashkët të njerëzve në të.

Për definicionin e këtillë vërehet që shkohet në skajshmëri tjetër, respektivisht përjashtohet pamja e jashtme, pra forma. Për këtë arsye është e nevojshme sinteza e elementeve bazë të dy definicioneve. Si rezultat i kësaj vërtetohet se vepra penale përfaqëson “sjellje të rrezikshme me të cilën rrezikohen të mirat, vlerat, interesat e marrëdhënieve të individit dhe shoqërisë të cilat ligjvënësi ka shpallur të një rëndësie të lartë, duke parashikuar dënime ose sanksione tjera për kryersin e saj”.

Definicioni i lartëpërmendur është bashkim i qasjes formale dhe material, por është thjesht objektive që domethënë se duhet të meret parasysh raporti psikik e kryersit ndaj veprës, respektivisht ana subjektive, pra të meret parasysh elementi i fajsisë.

Me shtimin e kësaj definicionii përgjithshëm i termit vepër penale do të dukej kështu : vepra penale paraqet sjellje të rrezikshme shoqërore me të cilën dëmtohen të mirat, vlerat, interesat dhe raportet e individit dhe shoqërisë të cilat ligjvënësi i ka shpallur të një rëndësie të lartë, duke parashikuar dënime dhe sanksione penale për kryersin e saj

Termi vepër penale është rregulluar me nenin 7, nga LP, në këtë mënyrë: vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila me ligj është e përcaktuar si vepër penale dhe karakteristikat e së cilës janë të përcaktuara me ligj.

Ky definicion është pastër formal që domethënë se ligjvënësi jonëe shmangë termin sjellje e rrezikshme shoqërore dhe qasjes material për përcaktimin e termit vepër penale.

Elementet bazë të veprës penale janë:

1. Sjellja e personit,
2. Kundërligjshmëria
3. Faji, dhe
4. Dënueshmëria

1.5.1 Pjesëmarrja e më shumë personave në kryerjen e veprës penale

Vepra penale mund të kryet nga një apo më shumë persona. Nëse bëhet fjaë për situatën e dytë atëher kemi pjesmarrjen e më shumë personave në kryerjen e veprës penale.

Gjegjësishtë, gjatë kryerjes së një vepre nga ana e shumë personave bëhet kumulimi i energjisë kriminale për realizimin e ndonjë dëmi të qëllimshëm me të cilën kërcënohen apo dëmtohen të mirat, vlerat, marëdhëniet dhe interes e shoqërisë. Bashkimii më shumë personave për kryerjen e veprës penale tregon për rrezikun e veçantë, sepse këtu bëhet fjalë për njëllojë organizimi, vendosshmërisë së të gjithë pjesëmarësve në mënyrë të përbashkët për realizimin e ndonjë qëllim.¹⁷

¹⁷Gjorgji Sllamkov, E drejta penalepjesa e përgjithshme, Cetis, Shkup, 2009, faq.233.

Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e më shumë personave në kryerjen e veprës penale duhet që ndërmjet kryesve të veprës penale të ekzistojnë lidhje të caktuara, të karakterit objektiv dhe subjektiv.

Ligjvënësit tanë, problematikën që ka të bëjë me kryerjen e veprës penale nga ana e shumë personave e përpunon në nenet 22-25 të Kodit Penal, nën titullin „Pjesëmarrje në veprën penale”, dhe gjatë së cilës numrohen tre llojet e tij: bashkëpjesëmarrja, nxitja dhe ndihma.

Bashkëpjesëmarrja ekziston atëherë kur secili nga pjesëmarrësit e pranon veprën si të vetën, apo merë pjesë në ndërmarrjen e veprimtarisë së kryerjes së veprës penale.

Bashkëpjesëmarrja paraqitet si kontribut në realizimin e veprës së huaj, nuk meret pjesë në veprimtarinë e kryerjes së veprës penale.

Bashkëpjesëmarrja paraqitet në dy lloje: nxitja dhe ndihma. Nxitja paraqet krijimin apo forcimin e vendimit tek disa persona për kryerjen e veprës penale. Ndihma si lloj i bashkëpjesëmarrjes paraqet ndërmarrja e veprimtarive në nivelin e ndihmës, me të cilën njëri person i ndihmon, ia lehtëson kryerësit gjatë realizimit të veprës penale.

KAPITULLI II

2. Format e krimit të organizuar

2.1 Nocioni për teroroizmin dhe krimin e organizuar dhe lidhshmëria ndërmjet tyre

Në kuptimin aktual, fjala “terrorizëm”, për herë të parë është përdorur në Rusi gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX. Që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, format e ndryshme të dhunës politike të drejtuara kundër shtetit kishin filluar të emërohen si “veprime terroriste”. Këtë kuptim “terrorizmi” e ka rruajtur deri në ditët e sotme. Në realitet, në kuptimin politiko-historik, me nocionin terrorizëm, fillimisht janë kuptuar të gjitha format e dhunës politike të drejtuara kundër shtetit. Gjithashtu, edhe në kuptimin juridik dhe politik, me fjalën terrorizëm, kuptohet zbatimi i formave të ndryshme të dhunës ilegale me qëllim të shkaktimit të ndjenjave të frikës dhe panikut shoqëror, si mjet të detyrimit për realizimin e qëllimit të caktuar politik. Dallimi thelbësor në mes të veprave penale terroriste dhe atyre klasike kriminale (vrasjet, rrëmbimet e personave, plaçkitjet, etj.) ka të bëjë me qëllimin e tyre. Dhuna terroriste është e drejtuar zakonisht kundër aparatit të caktuar shtetëror ose përfaqësuesve të tij me qëllim të ndikimit në realizimin e interesave të caktuara politike. Kjo do të thotë, dhuna terroriste parimisht nuk është e drejtuar kundër qytetarëve të rëndomtë ose grupeve të ndryshme shoqërore, por kundër shtetit dhe përfaqësuesve të tij.¹⁸

Terrorizmi është veprim afatgjatë strategjik që ka një qëllim krejtësisht tjetër nga luftërat ndërshtetërore, kryengritjet e armatosura, grushtshtetet ose luftërat qytetare. Qëllimi i terrorizmit nuk është okupimi, përkatësisht çlirimi i terrorit ose shkatërrimit i bazës materiale të armikut.¹⁹

Terrorizmi dhe krimi i organizuar, edhe pse me një histori më të thellë dhe më të largët të ekzistencës së saj, duket se asnjëherë nuk ka pasur rol të rëndësishëm në pengimin e standardeve të jetesës civilizuese dhe destabilizimin e sistemit shtetëror të sigurisë, siç është, fatkeqësisht sot. Duket se terroristët dhe grupet kriminale në ditët e sotme nuk kanë kufi.

¹⁸Terrorizmi ndërkombëtar, Kolë Krasniqi Prishtinë 2010, faqe 25-26

¹⁹Po aty.

Shumë autorë si Zllate Dimovski, M.Niollovski të cilët meren profesionalisht dhe shkencërisht me terorizmin, këtë fenomen e kondiderojnë si një formë të krimit të organizuar. Duke pasur parasysh dallimet në qëndrimet midis gjithë këtyre autorëve dhe autorit të këtyre reshtave, së pari është e nevojshme që në linja të shkurta të sqarojmë terorizmin në të gjitha dimensionet kriminogjene, që në fund të këtij kapitulli të kundërshtojmë argumentet dhe kundra argumentet në raport me tezën se a është terorizmi një prej formave të krimit të organizuar ose jo. Për këtë qëllim, në bazë të konfrontimit racional të premisave të argumentuara me anë të parimeve metodologjike shkencore do të mundohemi të vijmë deri tek konkluzioni me domethënie shkencore praktike me implikime dhe konsekuenca operative.

Sipas profesor Lupco Arnaudovski²⁰ “terorizmi në botën bashkëkohore dhe në praksën politike dhe në domethënien e përgjithshme dhe politike përfaqëson përdorimin e dhunës së organizuar të individëve dhe grupeve, respektivisht shteteve të cilat janë të përgatitura që edhe përmes mënyrës fizike, duke përfshirë këtu edhe atentatet dhe vrasjet, si dhe maltretimet, për ta implementuar vullnetin e tyre në shtet dhe të zbatojnë terror psikik në masë duke shkaktuar komplekse kolektive dhe frikë, apati dhe pasiguri”. Këtu do ta përmend edhe definicionin e M.Nikolovski me të cilin ai e specifikon termin e “terorizmit”. Sipas tij terorizmi është “përdorimi paprituri dhunës në mënyrë të organizuar dhe të matur, nga ana e individëve ose grupeve, deri edhe të shtetit, të cilët janë të përgatitur që përmes sulmeve fizike (atentate, kidnapime dhe vrasje) ta imponojnë vullnetin e tyre ndaj shtetit dhe shoqërisë duke përdorur terror psikik ndaj masave, duke shkaktuar frikë, panikë dhe pasiguri tek qytetarët dhe mosbesueshmëri ndaj institucioneve”.²¹ Terorizmi përfaqëson aktivitet kriminal me përdorim të forcës së ashpër dhe metodave tjera të dhunës nga ana e individëve, grupeve, organizatave teroriste, rrjeteve teroriste ose shteteve me qëllim të shkaktimit të frikës masive, pasigurisë dhe mosbesueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të sistemit, me qëllim të detyrimit të qëverive për realizimin e interesave politike ideologjike dhe ekonomike, nacional separatiste apo kauzave fetare.

Teza sipas së cilës egziston lidhja mes terorizmit dhe krimit të organizuar mundet të vërtetohet me analizën e veprimit të disa organizatave teroriste ose grupacioneve dhe shoqatave

²⁰M.Nikolovski, „Lidhshmëria dhe ndikimi i krimit të organizuar, terorizmit dhe politikës”, Shkup, 2008 vit., faq.32

²¹Po aty.

të organizuara kriminale, të cilat me veprimin praktik të tyre për realizimin e qëllimeve të tyre shpesh herë përdorin mjete dhe mënyra të llojit tjetër kriminal, ose thjeshtë vin deri tek lidhja e tyre për veprim të përbashkët kur përputhen interesat.

Duke pasur parasysh që për të dy fenomenet nuk ekziston një definicion universal, i cili në tërësi do ta sqaronte ekzistencën e saj, nuk duhet të na befasojnë mendimet dhe qëndrimet e ndryshme lidhur me atë a është terorizmi njëra nga format e krimit të organizuar; apo janë dyforma krejtësisht të ndryshme të krimit apo krimi i organizuar e shkakton dhe mundëson terorizmin?

Megjithatë, është i pamohueshëm fakti se ekzistojnë lidhje dhe korelacione midis terorizmit dhe krimit të organizuar respektivisht ndërmjet organizatave terroriste dhe organizatave kriminale. Por, duhet të kemi parasysh se ato ekzistojnë dhe funksionojnë sit ë vecanta, si dukuri relativisht të pamvarura.

Dallimi midis terorizmit dhe krimit të organizuar shifet në elementet e rëndësishme si: Terorizmi dhe krimi i organizuar përdorin metoda të ndryshme, pajisje dhe teknika për funksionim dhe veprim; terorizmi përdor forcën dhe forma tjera të dhunës, me qëllim të shkakimit të frikës dhe pasigurisë tek masat e gjëra me qëllim të arritjes së qëllimeve terroriste; qëllimet për shkak të cilave vepron terorizmi janë para së gjithash të natyrës politike ideologjike, nacional-separatiste ose të natyrës fetare, përderisa qëllimet kryesore të krimit të organizuar janë përfitimi dhe fuqia.

Nga dallimet dhe ngjashmëritë e përmendura mund të shifet se terorizmi dhe krimi i organizuar janë pothuajse identik në aspektin organizativ. Por nga ana metodike dhe e qëllimit, këta dy fenomene dallohen tërësisht.

2.1.1 Definimii termit – terorizëm

Realiteti ndërkombëtar social është i ngarkuar me kriza politike, ekonomike dhe kriza ushtarake dhe konflikte, si dhe me forma të ndryshme të kërcënimeve jo ushtarake, që sjell deri tek pasoja të shumta në fusha të ndryshme, të cilat janë të një rëndësie të vecantë për realizimin e lirive themelore apo sigurisë së individëve, shtetit dhe shoqërisë në tërësi.

Shumë kundërshti sociale kanë shkakuar ritje të të gjitha formave të dhunës në nivel global, duke pasur efekt shkatëruës në stabilitetin e secilit rend shoqëror. Në kuadër të kësaj

duhet të shihet edhe terorizmi, si një sëmundje shumë e rrezikshme e cila është kërcënim bër botën moderne dhe për sigurinë globale.

Është i njohur fakti se ende nuk është sjell një definicion i pranueshëm për terorizmin, ashtu që definicioni për konceptin e terorizmit shifet nga këndvështrime dhe pozita të ndryshme, (juridike, politike, historike, filozofike, psikologjike, teologjike, etj). Ashtuqë, edhe pas shumë tentimeve, edhe sot egziston dallimi në definim, dhe që do të zgjat shumë kohë për shkak të përdorimit të qasjeve të ndryshme shkencore të studimit. Për tu definuar terorizmi duhet tu përgjigjemi disa pyetjeve. Pse dikush tenton, që nëpërmjet formave të ndryshme të dhunës drejt arritjes së caqëve të caktuara politike?

Arsyet mundet të jenë të ndryshme, por duhet të nisemi nga fakti që raportet midis grupeve të ndryshme kolektive të njerëzve janë në kundërshtim dhe në konflikt interesi. Mjetet demokratike duhet të meren me këto kundërshtime dhe konflikte të interesit, por fatkeqësisht kjo rrallë ndodh, pasi që njëra nga palët kundërshtare anon kah mjetet jodemokratike respektivisht përdor dhunën.

Fjala – koncepti i terorizmit (fjalë latine, *terroris* – frikë, *terror*), nënkupton forma të organizuara dhe të planifikuara me qëllim shkaktimin e frikës, që duhet të rezultojnë me thyerjen e rezistencës që qëndron përballë rrugës së realizimit, më shpesh këto janë arritja e qëllimeve politike.²²

Koncepti i terorizmit, është futur në dy shekujt e fundit, si (i keq, i frikshëm, johuman, brutal, jolegal, i paparashikueshëm) fenomen që i detyron të gjithë kolektivitetet njerëzore dhe i cili udhëhiqet për qëllime të ndryshme (politike, fetare, etnike, sociale, etj.). Minimalisht anojnë kah dhuna brutale fizike me qëllim të shkaktojnë (produkt) efekt maksimal (frikë) në mënyrë që kundërshtari të vendoset në pozitë të dorëzimit pakusht, me këtë sigurohen edhe mjete për tu siguruar qëllimet, arritja e qëllimit të projektuar politik.

Legjislacioni penal i secilit shtet, e trajton terorizmin si një nga krimet më serioze dhe në masë të madhe është i përcaktuar nga se vijon: ai i cili me qëllim bën kompromis, përgatitën për të kryer akt dhune, me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë tek qytetarët, do të dënohet.

Me qëllim të trajtimit më të gjërësishëm të aspekteve të terorizmit, kemi edhe disa definicione nga autorë të ndryshëm.

²²Terrorizmi ndërkombëtar , Kolë Krasniqi Prishtinë 2010, faqe 24

Shpesh, në teori dhe praktikë si të njëjta identifkohen termet terror dhe terrorizëm. Ashtu terorizmi përfshin akte të dhunës për qëllime politike, e organizuar për të friguar dhe për të thyer rezistencën kundër atyre që u bëhet terrori.

Terorizmi është masë sistematike dhe e organizuar e dhunës me qëllim të shkaktimit të frikës dhe pasigurisë ndaj qytetarëve, e rënojnë autoritetin e shtetit dhe janë të drejtuar drejt realizimit të qëllimeve politike.²³

Terorizmi është akt i planifikuar i dhunës të cilën e kryejnë disa grupe shoqërore, me qëllim të mbrojtjes ose fitimit të pushtetit.

Për kryerjen e aktiviteteve terroriste, janë të nevojshme mjete të caktuara financiare, të cilat u nevojiten organizatave terroriste për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e qëllimeve të përcaktuara.

Organizatave terroriste, mjetet e financimit i marri prej burimeve legale dhe jolegale të financimit

Si burime financiare, organizatave terroriste më së shpeshti përdorin burime jolegale të financimit, edhe ato më së shpeshti financohen nëpërmjet tregtimit të drogës dhe armëve, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i migrantëve, larja e parave, kidnapimi me qëllim shpugimi dhe të ngjashme.

Me rënien e Bashkimit Sovjetik, ndodhën ndryshime të mëdha në bashkësinë ndërkombëtare, gjatë së cilës grupe të caktuara dhe organizata i humbën financuesit e tyre kryesorë dhe u detyruan të gjejnë alternative tjera të financimit.

Si alternativë nga e cila më shpejtë dhe më lehtë do të financohen, organizatave terroriste filluan bashkëpunim të afërt me organizatave kriminale të cilat meren me tregtimin e drogës dhe gjatë kësaj shumicës së organizatave kriminale „u filloi mbarë”, për arsye se në rajonet ku ato vepronin kryej edhe prodhimin e drogës ose të njëjtat vende ishin “tranzit” vende të narkotikëve.

Përveç kësaj, SHBA luajtën rolin kryesor në rolin dominant në **“luftën kundër terrorizmit”**, me ndërprerjen e financimit të terrorizmit, duke përfshirë bllokimin e transaksioneve dhe llogarive financiare të individëve dhe organizatave humanitare të lidhura me terrorist. Zhdukja e burimeve

²³Terrorizmi, Haki Demolli Prishtinë 2002, faqe 19

të financimit i detyroi organizatat teroriste ta zhvillojnë ‘narko-terorizmin’, i cili gjithnjë më shumë do të kycet në tregtimin e drogës për të siguruar mjete materiale dhe financiare.²⁴

Tregtia me drogë u bë njëra prej burimeve kryesore të financimit të grupeve të organizuara kriminale dhe organizatave teroriste.

Për arsye se tregtia me drogë mer hov të madh dhe u mundëson organizatave teroriste ‘para të shumta’, vet organizatat teroriste shpeshherë bëjnë tregti me lëndë narkotike, ose bashkëpunojnë me grupe të organizuara narko kriminale, me të cilat bashkë e ‘tejkalojnë’ ligjin, shfrytëzojnë të njejtat rrugë ilegale përmes të cilave e transportojnë ‘mallin’, koruptojnë të njejtët zyrtarë shtetërorë, përdorin teknika dhe metoda të ngjashme për realizimin e kontrabandës me narkotikë me çrast përfitojnë mjete financiare të nevojshme për funksionimin normal dhe për realizimin e qëllimeve të caktuara. Me vet këtë, organizat teroriste, jo vetëm që përfitojnë mjete financiare për realizimin e aktiviteteve të tyre, por njëkohësisht, vet krimin e organizuar e përdorin si mjet i cili mund të ‘rrëzojë’ funksionimin e një sistemi.

Si ngajshmëri dhe lidhje që ekzistojnë midis grupeve teroriste dhe organizatave kriminale mund të themi se të dy grupet veprojnë në mënyrë sekrete me rrjete të ‘nëntokës’ duke bërë shtypje dhe përdorin dhunë ndaj viktimave civile.

Poashtu organizatat kriminale dhe grupet teroriste përdorin teknika të ngjashme të veprimit, kidnapojnë për përfitim, dhunojnë, vrasin persona të caktuar që u ‘pengojnë në rrugë’ për realizimin e qëllimeve të tyre. Vet kontrollimi i grupit, nga aspekti individual është i ashpër. Të dyjat përdorin organizata fronti, të cilat i përfaqësojnë dhe shfrytëzojnë si sektore legjitime biznesi.

Më shpesh organizatat kriminale dhe grupet teroriste përdorin shtete me kontroll të dobët qëveritar, e cila nuk mundet tu kundërvihet në aktivitetin e tyre.

Në aktivitetin e tyre përdorin teknologji të njejtë ose të ngjashme, mjete teknike të ngjashme për realizimin e komunikimit të ndërsjelltë.

Për të dyja organizatat, të hollat janë shumë të rëndësishme, për grupet kriminale të organizuara i rëndësishëm është vetëm profiti nga aktiviteti kriminal, ndërsa për organizatat teroriste të hollat u nevojiten për realizimin e qëllimeve të planifikuara më parë.

Gjatë kësaj, të dyja grupet më së shpeshti financohen prej aktiviteteve fitimprurëse kriminale, të cilat u mundësojnë kapital të madh, të cilin më vonë, një pjesë e përdorin për

²⁴Terrorizmi, Haki Demolli Prishtinë 2002 faqe 21

funksionim normal, ndërsa pjesën tjetër për korumpimin e zyrtarëve shtetërorë dhe qeveri, nëpërmjet bashkëpunimit dhe ndihmës së tyre u ikin problemeve dhe sanksionimit që duhej të pason për shkak të aktivitetit jolegal.

Vetë grupet e organizuara kriminale dhe terroristët shpeshëhere veprojnë si strukturë në rrjet, e cila u ndihmon terroristëve të fshihen në organizatat kriminale transnacionale.

Aktivitetet e terroristëve dhe grupeve të organizuara kriminale para së gjithash janë të drejtuara, jo vetëm kundër qeverive zyrtare (shteteve), por edhe kundër bashkësisë ndërkombëtare dhe rendit botëror. Të hollat që i fitojnë janë të nevojshme për të dyja organizatat që të funksionojnë normalisht.

Një studim kanadez identifikon pesë lloje të bashkëpunimit mes organizatave terroriste dhe grupeve të organizuara kriminale që meren me tregtinë e drogës edhe ate: operative, logjistike, financiare, politike dhe ideologjike. Vetë studimi tregon se natyra e lidhjeve para së gjithash është logjistike dhe financiare, prezencë e lidhjes së bashkësive, por që i rrallë është bashkëpunimi i karakterit ideologjik.

Si dallime që paraqiten midis organizatave terroriste dhe grupeve të organizuara kriminale, mund të themi se grupet terroriste janë zakonisht të motivuara ideologjikisht dhe politikisht, derisa grupet e organizuara kriminale janë organizata profitabile, pra organizata kriminale të organizuara veprojnë me qëllim të realizimit të përfitimit sa më të madh financiar, përderisa organizatave terroriste të hollat janë të nevojshme për funksionim normal, për ushtrime, furnizim me armë, përgatitje të terrenit për realizimin e aktit terrorist.

Mjetet financiare, organizatat terroriste i përdorin për realizimin e qëllimeve të tyre, të cilat janë politike, fetare, apo të karakterit ideologjik. Organizatat terroriste shpeshherë luftojnë me qeveritë rreth legjitimitetit, përderisa grupet kriminale nuk e bëjnë këtë.

Gjatë kryerjes së aktiviteteve, organizatat terroriste kërkojnë vëmendjen e medimeve, të jenë në ballinat e gazetave, të prezentohen në lajme, në të gjitha web portalet, të ndëgjohej kudo se ato ekzistojnë, dhe nëse qeveritë nuk veprojnë sipas kërkesave të tyre mund të shkaktojnë edhe më shumë dëme.

Këtu do të përmendim edhe **faktin se pas çdo akti terrorist, në të shumtën e rasteve përgjegjësinë e marin vet grupet terroriste,** ka edhe raste kur grupet terroriste marin

përgjegjësinë edhe për aktet që nuk i kanë kryer, e gjithë kjo me qëllim për ta promovuar vetë organizatën dhe të ndëgjohet se ekziston dhe është e përgatitur për ti realizuar qëllimet e veta.

Nga ana tjetër, grupet e organizuara kriminale duan që sa më shumë të ngelen anonime dhe të mos tërhekin vëmendjen tek publiku.

Mes organizatave teroriste dhe grupeve të organizuara kriminale ekzistojnë dallime të caktuara në raport të dallimit të metodave dhe mënyrës së veprimit. Vet organizatat teroriste nuk e pranojnë rendin juridik dhe rregullat e sjelljes dhe janë të drejtuara kundër legjitimitetit të qeverive.

Terorizmi sii tilë ka një dimension më të gjërë psikologjik, në raport me krimin e organizuar.

Duke i shqyrtuar kërcënimet dhe sfidat e kohëve aktuale, duhet ti jepen më shumë rëndësi kuptimit dhe lidhjes mes krimit të organizuar dhe terorizmit dhe të zbatohen masa adekuate anti-teroriste, kundër-teroriste dhe lloje të tjera të masave dhe aktiviteteve në luftën efikase kundër terorizmit dhe krimit të organizuar.²⁵

2.2. Krimi i organizuar transnacional

Transformimi dhe ritja e krimit të organizuar në gjysmën e dytë të shekullit 20 u mundësua duke i falemnderuar paraqitjes së disa faktorëve, duke përfshirë edhe liberalizimin dhe globalizimin, kërkesën e ritur për mallrat dhe shërbimet jolegale në nivel global, ngritjen e ‘‘shteteve të pasuksesshme’’ dhe shtimin e luftërave qytetare. Liberalizimi ekonomik dhe hapja e kufijve shkaktoi rritjen e lëvizjes së qytetarëve dhe mallrave, me përjashtim të asaj që ato janë të dobishëm për zhvillimin e sektorit jolegal.²⁶ Organizatat kriminale janë figurat më të forta të rendit të ri botëror dhe shpeshherë quhen si ‘‘organizata kriminale transnacionale’’.²⁷ Termi ‘‘transnacionale’’ më së shpeshti përdoret për të synuar lëvizjen e informatave, të hollave, artikujve fizikë, njerëzve ose mallrave nëpërmes kufijve nacional, me kusht që njëri prej pjesmarësve i lidhur me transakcionin të jetë joqëveritar.²⁸

²⁵ Stajić, L. „Bazat e sigurisë“, Akademia policore, Beograd, 2003.

²⁶ Shanty, F. & Mishra, P. P.(2007). Organized Crime: from Trafficking to Terrorism. California: ABC CLIO.

²⁷ Bhattacharyya, G.(2005). Traffick: The Illicit Movement of People and Things. London: Pluto Press.

²⁸ Keohane, R. & Nye, J. (1971). Transnational Relations and World Politics. Cambridge, MA: Harvard University Press.

Me termin e krimit të organizuar transnacional nënkuptohen grupet kriminale të cilat kanë organizator ose (organizatorët) në një shtet, por për shkak të aktiviteteve kriminale veprojnë në shtete tjera. Krimii organizuar multinacional nënkupton grupe kriminale të bashkuara nga më shumë shtete, ashtuqë veprimtaria e tyre kryhet në më shumë shtete. Dhe në fund, krimi i organizuar global nënkupton të gjitha format e e krimit të organizuar nëpër botë. Edhe pse në të gjitha këto forma ka dallime në nuanca, në fakt bëhet fjalë për të njëjtën dukuri në variacione të ndryshme, ku grupet e organizuara kriminale veprojnë në më shumë shtete. Prej këtu konsideroj që përmbajtja e të gjitha variacioneve mund të nënkuptohet si një term, i cili konvencionalisht mund të përcaktohet si krimi i organizuar transnacional.²⁹ Implikimet praktike nga përdorimi i termit krimii organizuar transnacional janë me shumë kuptime. Sot, në kushtet e globalizimit dhe mundësive të shumta që i ofron ky proces në planin ekonomik financiar, komunikativ, transportues, social, juridik dhe politik, termi i krimit të organizuar përvec dimensionit transnacional thuhet nuk egziston i kufizuar në kornizat nacionale. Sipas kësaj, gjithcka që flitet për krimin e organizuar, në të shumtën e rasteve në fakt i referohet krimit të organizuar transnacional.

Kjo është kështu për shkak të thjeshta pasiqë është e pamundur një grup i organizuar kriminal, që meret psh, me tregtimin e drogës, qënieve të gjalla, armëve, kriminalitet financiar, korupsionit, kriminalitetit ekologjik ose të ngjashme ti kryej të gjitha këto aktivitete kriminale vetëm në një shtet, pasiqë në të shumtën e rasteve mallrat dhe shërbimet u janë të dedikuara tregjeve të vendeve tjera, transporti kryhet nëpërmes shumë shteteve, dhe në të shumtën e rasteve fshehja e të ardhurave fshihet në shtete offshore. Shumë rrallë në forma të caktuara kemi krim të organizuar, sic është reketi në nivel lokal, vrasje të porositura, vjedhje etj, të cilat mund të kryhen në teritorin e një shteti.

Grupet e organizuara kriminale transnacionale (GOKT) dallojnë dukshëm nga grupet kriminale tradicionale përmes disa karakteristikave konkrete: së pari ato gjenden në një vend; së dyti, aktivitetet e tyre kriminale kryhen në një ose më shumë shtete nikoqire janë me kushte me

²⁹ m-rMarjan Gaberov, Kriminalitet i organizuar transnacional – trendet dhe ngjarjet, EURM –Fakultetii shkencave politike, Shator, 2014 v.

të volitshme të tregut, dhe e treat, mundësia për kryerjen e aktiviteteve kriminale në shtete me politikë të butë dënuese.³⁰

Farer (Farer, 1999) nënvizon dy karakteristika specifike i cili mundëson dallimin e (GOKT) nga tradicionalja: kryerjen e aktiviteteve kriminale përmes kufijve nacional dhe identifikimin e aktiviteteve kriminale të grupeve kriminale si vepra penale.

Krimi i organizuar transnacional në mënyrë të suksesshme sfidon ndryshimet, si kushtet politike dhe ekonomike për zhvillim të shteteve moderne, si karakteristikë e fillimit të shekullit 21. Dallimi kryesor midis krimit të organizuar transnacional dhe atij tradicional, e cila shpeshherë përmendet në literaturë, është mundësia e kryerjes së aktiviteteve kriminale jashtë kufijve nacional ose bartja e sendeve jolegale në shtete që akoma nuk kanë vendosur administratë efikase shtetërore. Shembull tipik i shteteve të këtilla si "shtete të pasuksesshme" për shkak të faktit të vakumit të forcës që paraqitet në teritoret e tyre, këtë e shfrytëzon (GOKT) duke vendosur struktura të saja të fuqisë.

2.3. Larja e parave

Larja e parave ka të bëjë me veprimet të cilat ndërmiren në mënyrë që paratë e fituara nga transaksionet dhe aktivitetet kriminale të deponohen dhe investohen në punë dhe në veprimtari legale e pastaj ato do të përdoren si para të pastruara të lara. Procesi i larjes së parave ndahet në tri faza; faza e parë përfshinë instalimin apo transferimin fizik të parave të parave të cilat janë fituar si rezultat i veprimtaris kriminale. Faza e dytë përfshinë mbulimin ose shtresimin duke u kyçur në transaksione financiare komplekse për ti humbur gjutmët dhe rrugët e fitimit të parave të cilat janë mbledhur në mënzrë joligjore. Faza e tretë përfshinë përpjekjen dhe angazhimin që këto para të "pastruara" të paraqiten si formë e pasurisë dhe kapitalit të ri, të pastër legjitim.

Larja e parave, (gj.ang.: money laundering) nënkupton aktivitet kriminal nëpërmjet së cilit mundohet të fshihet prejardhja e vërtetë e mjeteve dhe të njejtave t'ju jepet legjitimitet. Kriminelët këte e bëjnë nëpërmjet fshehjes së burimeve, formave dhe llojeve të mjeteve ose

³⁰Shelley, L. I. (1999). Transnational organized crime: the new authoritarianism. The illicit global economy and state power. Friman, H. R. & Andreas, P. Friman, H. R., & Andreas, P. (Eds.). (1999). The illicit global economy and state power. Lamhan: Rowman & Littlefield.

transferimin e tyre në vende ku nuk tërheqin vëmendje. Dukuria e pastrimit të parave jo rastësisht implikon shumë vende të botës dhe institucionet e tyre bankare, për çka shpeshherë lindin edhe afëra dhe skandaletë cilat kanë jehonë të madhe politike por dhe reperkusione ekonomike e financiare.³¹

2.3.1 Definimi i nocionit larja e parave

Tregtia e paligjshme me drogë, armë, njerëz dhe të ngjashme mund të gjeneron shuma të mëdha të parave. Tregtimi i brendshëm, mitoja apo mashtrimet kompjuterike gjithashtu sjellin fitime të mëdha të cilat duhet të legalizohen nëpërmjet larjes së parave. Në kushtet kur aktiviteti kriminal gjeneron shuma të mëdha të hollave, individit apo grupit patjetër të gjejnë mënyra si ti kontrollojnë këto mjete pa e tërhequr vëmendjen rreth legalitetit dhe prejardhjes së këtyre mjeteve.

Integriteti i tregut të shërbimeve financiare dhe tregtare në masë të madhe mvaret nga perceptiooni funksionimit në kushte të përcaktuara juridike, profesionale dhe standarde etike. Integriteti përfaqëson një nga çështjet më të rëndësishme të çdo institucioni financiar.

Nëse mjetet që gjenerohen prej aktiviteteve kriminale mundet lehtësisht të lahen nëpërmes ndonjë institucioni të caktuar financiar, ky institucion mundet lehtë të bëhet pjesë e sistemit nëpërmes të cilit bëhet larja e parave. Për këto arsye vëmendje e veçant duhet tu kushtohet rreziqëve me të cilat përballë çdo institucion gjatë kryerjes së transaksioneve të caktuara financiare. Ajo që është e vlefshme për një institucion mundet të vlen për gjithë ekonominë kombëtare. Shtetet të cilat kanë institucione financiare në zhvillim dhe sisteme joadekuate të kontrollit mundet të transformohen lehtë në parajsë për subjektet që bëjnë larjen e parave.

Larja e parave mundet të ketë ndikim të rëndësishëm ekonomik dhe politik ndaj ekonomisë kombëtare. Krimi i organizuar mund të infiltrohet në institucionet financiare, të marrë kontrollin e sektorëve të rëndësishëm ekonomik nëpërmjet investimeve ose të koruptojë të punësuarit në organet shtetërore. Për këto arsye në nivel shteti duhet të merren masa për parandalimin e procesit të larjes së parave. Është shumë e rëndësishme që shteti të mundësojë bashkëpunim institucional mes organeve përgjegjëse në luftën kundër larjes së parave (law

³¹Kriminologjia Ragip Halili, Prishtinë 2016

enforcement), si dhe të njoftojë sektorin privat dhe qytetarët e thjeshtë nga rreziku që sjell procesi i larjes së parave.

2.3.2 Financimi i terrorizmit

Financimi i terrorizmit nënkupton aktivitetin e çdo individii cili me çdo lloj mjeti, direkt ose indirekt, në mënyrë të paligjshme dhe me vullnet mundëson ose mbledh mjete me qëllim të njejtat të shfrytëzohen në kryerje të veprave nga të cilat do të shkaktohet vdekje ose lëndime serioze trupore të civilëve ose personave tjerë të cilët nuk janë aktivisht të kyçur në konflikt të armatosur. Qëllimi i sulmeve të këtilla është frikësimi i qytetarëve ose detyrimi i qeverisë ose organizatave ndërkombëtare të pengoj ose të ndalojë ndonjë akt.³²

Rëndësinë që ia kushton Organizata ndërkombëtare në financimin për luftimin e terrorizmit mund të shifet në aksionet globale të koordinuara në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, ku janë të kyçura më shumë organizata ndërkombëtare të cilat janë në menyrë direkte ose indirekte të involvuara në luftën kundër terrorizmit, siç janë : Fondi monetar ndërkombëtar, Zyra e OKB për drogë dhe kriminalitet, Banka botërore, Drejtoria supreme e komitetit për luftë kundër terrorizmit, Interpoli dhe ekipi për monitorim i Rezolutës 1267.

Teknikat të cilat i përdorin larësit e parave në masë të madhe janë të njejtat me ato që përdorin për financimin e terrorizmit. Që të dyja kanë të njejtin qëllim – fshehjen e prejardhjes së mjeteve.

Financimii i terrorizmit mund të kryhet nga mjetet legale dhe jolegale:³³

- Aktivitet kriminal;
- Donacione dhe kontribute bamirësie;
- Aktivitet i ligjshëm ose gjysëm i ligjshëm;
- Sponsorizimi prej qeverive ose shteteve.

Fshehja e burimeve për financimin e terrorizmit, pa dallim nëse vijnë nga aktivitete legale ose ilegale është e rëndësishme pasi që nëse fshihen burimet njëherë aty kanë qasje përsëri për akte tjera terroriste. Larja e parave dhe financimi i terrorizmit kryhet përmes institucioneve financiare. Në qoftë se të ardhurat janë si rezultat i shitjes së drogës, armëve ose njerëzve është e qartë se ata janë paraqitur në para të gatshme.

³²Konventa për ndalimin e marrjes joligjore të mjeteve ajrore, Hag, 16 dhjetor, 1970.

³³Xhon Medinger, Larja e parave udhëzim për hetuesit penal, Shkup, 2009

Larja e parave me ndihmën e parave të gatshme (cash) bie në teknikën e ashtuquajtur tradicionale. Pavarësisht zhvillimit të teknologjisë, me paraqitjen e instrumenteve të reja bankare dhe mundësia për keqpërdorimin e tyre në funksion të larjes së parave dhe financim të terrorizmit, përsëri larja e parave është dominante në raport me teknikat tjera. Sistemi i institucioneve financiare, në fakt është sistem i bankave dhe institucioneve jobankare. Nëse kemi parasysh se faza e parë e larjes së parave është plasmani, mundet lehtë të vijmë në përfundim se bankat janë në shënjestër të kriminelëve të cilët kanë për qëllim ti legalizojnë mjetet e tyre financiare.

Larja e parave dhe financimii terrorizmit me ndihmën e transfereve elektronike është shumë i përfaqësuar.³⁴ Kartelat sa më shumë keqpërdoren në funksion të larjes së parave dhe financim të terrorizmit. Kjo vjen sidomos në shprehje gjatë blerjes së mallrave dhe shërbimeve të ndryshme nëpërmjet internetit. Këtu është shumë rëndë të vërtetohet identiteti i blerësit, janë të njohura rastet e vjedhjes së identitetit.

Përdorimi i kredive në funksion të larjes së parave dhe financim të terrorizmit në fakt nënkupton kombinim midis teknikave bashkëkohore dhe tradicionale. Në këtë rast subjekti nuk bën plasma të parave jolegale, por i vendos si garant për të fituar kredi. Nëse i miratohet kredia, subjekti, për ti larë paratë, nuk e kthen kredinë.

Pas mbarimit të afatit për kthimin e kredisë, subjekti e aktivizon garantin e sigurisë, respektivisht paratë jolegale të deponuara i shtyn në qarkullim financiar.

Larja e parave përmes aksioneve është njëra prej teknikave të reja. Më prezente janë aksionet me prurës, të cilat përmes bursës barten nga një subjekt në tjetër, pa mos u identifikuar. Larësit e parave më së shpeshti blejnë aksione prej kompanive të ashtuquajtura (shell companies) të cilat janë pa pronë dhe operacione, të cilat më vonë i shesin në tregun formal dhe joformal të aksioneve me vlerë.

Kompanitë e sigurimeve me prodhimet e tyre, gjithashtu, mund të jenë cak i subjekteve të cilat meren me larjen e parave dhe financim të terrorizmit. Shembull më i qartë është kur polisa e sigurimit vihet në shumë shumëfish më të lartë se vlera e sendit. Nëse deri tek sendi subjekti ka ardhur në rrugë jolegale, ai do të mundohet të aktivizojë siguracionin me qëllim të pagesës së polisës së sigurimit.

³⁴B.A.K.Rajder, Bota financiare në rrezik: rreziqet nga kriminaliteti i organizuar, larja e parave dhe korupsioni, Siguria 1994/3.

2.3.3 Fazat në procesin e larjes së parave

Larja e parave është process global i cili mund të kryhet me përdorimin e instrumenteve dhe metodave të ndryshme. Edhe në saj të dallimeve në këtë process, megjithatë në literaturë dominon mendimi se procesi i larjes së parave përbëhet nga këto tre faza:³⁵

- Plasmani;
- Fshehja;
- Integrimi.

Plasmani është faza e parë në procesin e larjes së parave, ku paratë e gatshme të përfituara nga aktivitetikriminal plasohet në institucione financiare ose përdoret për blerjen e të mirave.

Qëllimi i subjekteve që lajnë para është ta dërgojnë keshin sa më larg vendit të aktivitetit kriminal më qëllim të mos zbulohen prej autoriteteve. Është e mundshme që keshi të transformohet në mjete tjera si (ceqë rruge, etj).

Në fazën e dytë bëhet fshehja e burimit të ardhurave duke krijuar sistem për transaksione financiare të cilat kanë për qëllim të pamundësojnë ndjekjen e gjurmëve të parave jolegale. Qëllimi i fshehjes është ndarja e parave nga burimii tyre kriminal. Më së shpeshti fshehja bëhet përmes transferimit të parave në llogari të bankave tej-oqeanike (offshore banks). Transferimi i mjeteve bëhet përmes transferit elektronik. Përveç transferit elektronik të parave, kriminelët në fazën e fshehjes meren me transaksione të letrave me vlerë.

Integrimi përfaqëson fazën e fundit në procesin e larjes së parave. Në këtë fazë paratë integrohen me tranferin ekonomik legjitim dhe përfaqësojnë pjesë përbërëse të mjeteve të përgjithshme të atij sistemi. Integrimii parave të lara në rrjedhat ekonomike arihet në mënyrë që individi kriminogjen ose grupikriminal vërteton se të hollat janë fituar në mënyrë legale.

Në fazën e integritit subjektet që kryejnë larjen e parave më së shpeshti shfrytëzojnë këto metoda:

- Themelimin e kompanive anonime në vende ku privatësia është e garantuar. Kompanitë e sapothemeluara mundet në mënyrë legjitime të fitojnë kredi bankare dheta zgjerojnë fushën e tyre të veprimtarisë.

³⁵Alison. S. Bachus, From drugs to terrorism: the focus shifts in the international fight against money laundering after September 11, 2011, p. 8.

- Dërgimin e faturave të rejshe për import apo eksport me vlerë të tej-rritur të vlerës së mallit ose shërbimit e cila i mundëson subjektit bartjen e mjeteve nga një shtet në tjetër.
- Bartjen e thjeshtë të mjeteve nga bankat në pronësi të kriminelëve drejt një banke legjitime në një shtet tjetër. Është e njohur se në vendet e ashtuquajtura parajsë e tatimit, subjektet që lajnë para shumë lehtë bëhen pronarë të bankave.

2.4 Tregtia me njerëz

Trafikimi me njerëz, sic është e definuar prej OKB, do të thotë rekrutim, transport, transfer, strehim ose pranim të personave me ndihmën e kërcënimit ose përdorim e forcës për eksploatim. Në kuadër të faktorëve individual të cilët çojnë disa individë, sidomos gratë, në situatë të tregtisë me njerëz, ekzistojnë disa faktorë shoqëror, sic janë papunësia, varfëria, mungesa e shkollimit, si dhe krimi i organizuar.

Çdo vit, rreth 2 milion e 400 mijë njerëz janë viktimë e tregtisë me njerëz, ndërsa organizatat kriminale që meren me këtë fenomen përfitojnë rreth tre miliardë dollarë në vit. Si ditë europiane në luftën kundër tregtisë me njerëz shënohet 18-të Tetori.

Tregtia me njerëz është fromë e tërhekjes, mashtrimit, kushtëzimit ose formave tjera të zhvendosjes së njerëzve nga shtëpitë dhe vendet e tyre, të cilët pastaj detyrohen të punojnë pa pagesë ose me paga të ulta në kushte tejet eksploatuese. Mënyra konsiderohet si shitje ose tregti me njerëz, me karakteristika robëruese, dhe i cili në të shumtën e shteteve është jolegal.

Viktimat e tregtisë mund të shfrytëzohen në situatë të ndryshme, midis cilëve edhe prostitucioni, puna me dhunë (këtu bënë pjesë puna me dhunë ose robërimi për shkak të borxhit), dhe forma tjera të robërimit të detyrueshëm. Shitja e foshnjeve dhe fëmijëve për birësim ose për qëllime tjera gjithashtu konsiderohet si tregti me fëmijë.

Protokolli për pengim, shtypje dhe dënim për tregtimin me njerëz, sidomos të grave dhe fëmijëve (i njohur si protokoli i Palermos) është protokoli i Konventës kundër krimit të organizuar transnacional i OKB dhe tregtinë me njerëz e definojnë si “rekrutim, transport, bartje, strehim ose pranim të njerëzve, me ndihmën e shtrëngimit, kidnapimit, mashtrimit, keqpërdorimit të forcës në kushte të dhënies dhe marjes së mjeteve, për tu aritur pajtueshmëri për kontroll të njerëzve nga person i dytë, me qëllim të eksploatimit”.

Në shtator 2008, Protokoli prej 124 faqëve, u nënshkrua nga ana e 117 shteteve. Tregtimi me njerëz është industria kriminale me rritjen më të madhe në botë, me të ardhura vjetore që llogariten midis 5 dhe 9 miliardë dollar. Këshilli i Europës thekson³⁶: ‘‘

Në periudhën e dekadës së shkuar tregtimi me njerëz arriti përmasa epidemike, me treg të llogaritur vjetor prej 42.5 miliardë dollar.’’ Kombet e Bashkuara vlerësojnë se afërsisht 2.5 miliardë njerëz prej 127 shteteve të ndryshme janë shitur anembanë globit. Viktimat e tregtisë me njerëz kushtëzohen me frikësim, mashtrim, përdorim të dhunës, ose kidnapim të drejtëpërdrejtë³⁷.

Me qëllim të luftimit efikas të tregtisë me njerëz midis kufijve ndërkombëtarë është i nevojshëm bashkëpunimi midis shteteve. OSBE (organizata për siguri dhe bashkëpunim Europian), ad hoc organizata ndërqeveritare e kartës së Kombeve të Bashkuara, është një nga organet udhëheqëse në luftimin e këtij problem të tregtisë me njerëz, me fushëveprimi e cila i përfshin Amerikën Veriore, Europën, Rusinë dhe Azinë Qendrore.

- Pasqyrimi

Tregtia me njerëz dallon prej kontrabandës me njerëz. Tek kontrabanda me njerëz, njerëzit me anë të pagesës vullnetare e kërkojnë shërbimin prej kontrabandistit gjatë së cilës mund edhe të mos ketë mashtrim në marrëveshjen (jolegale). Pas mbërritjes në vendin e caktuar, personii kotrabanduar zakonisht vepron lirshëm.

Viktimës së tregtisë me njerëz, nga ana tjetër, nuk i lejohej të largohet dhe prej saj kërkohet të punojë ose të jap shërbime, që janë eksploatuese, për tregtarin me njerëz zose të tjerët. Marrëveshja mundet të jetë e përpiluar si marrëveshje pune, por pa pagesë ose pagesë të ulët dhe me kushte tejet shfrytëzuese. Ndonjëherë marrëveshja është e përpiluar si robërim për shkak të borxhit, gjatë së cilës viktimës nuk i lejohej ose nuk është në gjendje ta paguaj borxhin.

Viktimat ndonjëherë mashtrohen me premtime të rrejshme ose kushtëzohen fizikisht. Disa tregtues i detyrojnë ose manipulojnë me përdorim të mashtrimit, frikësimit, dashurisë së rrejshme, kërcënimeve dhe përdorimit të forcës, si dhe robërimin për shkak të borxhit.

Tregtia me njerëz është industri profitabile. Në disa rajone, si Rusia, Europa Lindore, Hongkongu, Japonia dhe Kolumbija, tregtia me njerëz kontrollohet nga ana e organizatave të

³⁶https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%A2%D1%80%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D1%98%D0%B0_%D1%81%D0%BE_%D0%BB%D1%83%D1%93%D0%B5 Trafikimi i qenieve njerzore.

³⁷ Po aty

mëdha kriminale. Megjithatë³⁸, pjesa më e madhe e tregtisë me njerëz kryhet përmes rrjeteve të grupeve më të vogla të cilat janë të specializuara në fusha të ndryshme, transport, reklamim ose shitje. Kjo është shumë fitimprurëse pasi që nevojiten pak mjete, ndërsa ndjekja është shumë e rrallë.

Viktimat e tregtisë me njerëz zakonisht janë njerëzit nga pakicat më të dobëta dhe më të pafuqishme të rajoneve të caktuara. Ato shpesh vijnë nga rajonet e varfëra ku mundësitë janë të kufizuara, shpesh janë pakica etnike, shpeshherë janë refugjatë, por mundet ti përkasin edhe shtresave tjera shoqërore, klase ose race.

Edhe pse numri më i madh i viktimave janë prej shtresave të varfëra dhe pakicave të ndryshme, ato mund të jenë prej kudo. Nuk ekziston tip i caktuar i viktimës nga tregtia me njerëz. Shpeshherë njerëzit mendojnë se viktimat vijnë nga shtete të varfëra, por ndodh që ato të vijnë nga familje të pasura të SHBA-ve. Ky lloj krimi ndodh në atë mënyrë që shpeshherë njerëzit nuk e vërejnë, thuajse nuk e kuptojnë thellësinë e problemit.

2.5 Tregtia e paligjshme me drogë dhe substanca psikotrope

Tregtia e paligjshme me drogë, narkobiznesi, ose narkotregtia, paraqet një llojtë „tregut të zi” në të cilën zhvillohet shitëblerja e së njejtës dhe në bazë të së cilës realizohet edhe fitim i madh. Kuptohet se ky treg i zi e përfshinë kultivimin e substancave psikotrope (drogat), prodhimin e tyre, distribuimin ndërkufitar dhe në fundë edhe shitjen e substancave të caktuara (drogave) të cilat janë të ndaluara me ligjë. Në shumë vende të botës, tregtia me drogë është e ndaluar dhe është inkriminuar në Legjislatulën penale si vepër penale e cila është e dënueshme. Në Republikën e Maqedonisë ky llojtë i veprës penale e lidhur me drogën është inkriminuar në kapitullin 21 të Kodit Penal.

Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekurseve (neni 215 nga KP) dhe lejimi i përdorimit të drogave narkotike (neni 216 nga KP) paraqesin vepra penale për të cilat janë paraparë dënime me burgë për kryesit. Në vendet e caktuara siç janë Kina, Irani dhe Singapuri tregtia e paligjshme me drogë dënohet edhe me dënim me vdekje.

³⁸https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%A2%D1%80%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D1%98%D0%B0_%D1%81%D0%BE_%D0%BB%D1%83%D1%93%D0%B5Trafikimi i qenieve njerzore.

Tregtia e paligjshme me drogë paraqet gjendje serioze kombëtare (brenda shtetit) dhe ndërkombëtare apo internacionale ndaj së cilës duhet qasje globale. Droga aspak nuk është problem i lehtë dhe paraqet kërcënim të madhë për shëndetin, sigurinë, prosperitetin e popullatës dhe veçanërishtë rinisë. Këtu duhet të theksohet edhe narkomanija si një fenomen negativ socialo devijues apo socialo/patologjike e cila është shumë akute në botë. Edhe përkundër hulumtimeve bazë të këtij fenomeni, është vështirë që të vërehet deri në fundë etiologjia e saj dhe konsekuencave negative të saj, gjegjësishtë pasojat, si dhe të ndërtohen instrumente dhe mjete efikase për parandalimin dhe luftimin e saj.³⁹Te tregtia e palejuar me drogë ndërlidhen shumë aspekte siç janë shëndetësore, socilae, penale, etike dhe të ngjashme. Përdorimi i drogave të forta bënë pjesë në grupin e fenomeneve sociopatologjike.

Të gjitha të dhënat statistikore tregojnë se dy deri tre deceniet e fundit gjithnjë e më shumë ritet në mbarë botën.⁴⁰Fenomeni i lidhur me drogën dhe masat dhe aktivitet që duhen të ndërmeren janë komplekse dhe me një vazhdimësi të gjërë e cila përfshinë prevenimin, trajtimin, zvoglimin e dëmeve, reintegrimin social, kontrollin juridik, zbatimine ligjit, veçanërisht duke mare parasyshë se përdorimi i drogës, trended, si dhe prodhimi dhe tregtiee paligjshëm me drogë janë shumë dinamike dhe gjithnjë ndryshohen. Çdo shtet ka karakteristikat e veta ku janë të përfshiaë dhe organizuara grupet kriminale, ku i realizojnë përfitime e tyre të mëdha, por padyshim se tregtia e paligjëëshme me drogë, është ne vendin e parë në botë ku realizohen përfitimet jolegale.

Aktiviteti më fitimprurës i krimit të organizuar është tregtia me drogë ku qytetarët e Bashkimit Evropian harxhojnë më së paku 24 miliard euro në vit.⁴¹Keqëpërdorimi i drogave dhe sëmundjet e varësisë nga droga janë të lidhura me problemet globale shoqërore siç janë varfëria, papunësia, delikuenca, kriminaliteti, strehimi, përderisa qarkullimi i parave nga narko kriminaliteti mundë të ketë ndikim të rëndësishëm në stabilitetin shoqëror, zhvillimin e shoqërisë, proceset demokratike e cila e kushtëzon vuajtjen edhe të individit por edhe të familjes, dhe çon deri të humbja e jetës njerzore.⁴²Nëse shihet ajo që u tha më parë dhe nëse meret

³⁹Metodija Kanevçev, Pjesa e veçanë e së Drejtës penale, faq.264

⁴⁰Todor Vitllarov, Edrejta penale,Pjesa e veçanë me shembuj praktik, ligjerata të autorizuara, faq.56,2013 vit.

⁴¹Raporti i përbashkët nga Europol, Agjencia Evropjane e policisë dhe Qendra Evropjanepër mbikqyrjen e drogës dhe varshmërisë(EMCDDA).

⁴²<http://www.cph.mk/ftp/Strategji/Nacionalna%20strategjia%20za%20droga%20%20mkd%20strategjia%202014-2020.pdf>

parasyshtë, mundë të themi se qytetarët dhe institucionet në R. e Maqedonisë janë të vetëdijshme për këto probleme dhe reziqe, dhe jepë përkrahje aktive edhe në teritorin e vet edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë me vendet nga rajoni dhe bota, me një politikë transparente dhe konzistente për luftën kundër drogës, me qëllim që të sigurohet jeta e shëndetshme, dinjitoze dhe siguria e individit – njeriut dhe tërësisë së përgjithshme shoqërore.

2.6 Kriminaliteti i dhunshëm dhe pronësor

Kriminaliteti pronësor paraqet kërcënim serioz për shkak të vëllimit të madh të veprave penale, pasojave direkte ndaj qytetarëve si dhe dëmeve të mëdha materiale që i shkaktohen nga ky lloj i krimit. Përfitimii shpejtë dhe i lehtë i personave të përfshirë në krimin pronësor ndikon në tërheqjen e shkelësve të ri, të cilët më së shumti janë nga popullata e re. Aktivitetet kriminale të grupeve të organizuara kriminale të cilat krimin pronësor e kanë aktivitet primar, karakterizohen me ndryshime të shpeshta të lokacioneve me qëllim të shmangjes së detektimit.

Efekti i krimit pronësor i cili ndikon në ecurinë normale të jetesës së qytetarëve, para së gjithash për shkak të shkeljes së të drejtave të garantuara, e drejta për mbrojtje të pronës dhe të drejtës së pronësisë, shkakton ndjenjën e sigurisë së rrezikuar dhe është një nga arsyet pse të gjithë shtetet i kushtojnë vëmendje të veçantë dhe e kanë prioritet në punën policore. Aktivitetet kriminale në fushën e krimit pronësor, në masë të madhe i shqëtësojnë shtetet dhe qytetarët, para së gjithash për shkak të dëmeve të mëdha materiale.

Krimi pronësor i përfaqësuar nëpërmjet „vjedhjeve të rënda” dhe „grabitjeve” e karakterizojnë masoviteti, numrii madh veprave penale të pandriçuara, nivelii lartë profesional i kryerjes, përdorimi i mjeteve të sofistikuara dhe recidivizmi tek kryerstit e aktit. Mundësia për përfitim të lehtë dhe të shpejtë në këtë lloj aktiviteti kriminal ndikon dukshëm në rekrutimin e pjesëmarrësve të ri të cilët involvohen në këtë lloj krimi, në veçanti popullata e moshës së re (adoleshentët).

Për grupet kriminale të involvuara në krimin pronësor, në veçanti vjedhjet e rënda, këtë lloj aktiviteti e kanë aktivitet primar ku veprat i kryejnë në kontinuitet ose në mënyrë periodike.

2.7 Sajber krimi dhe sajber siguria

Krimi i lartë teknologjik zë vend sa më të rëndësishëm në strukturën e krimit bashkëkohor,

ndërsa reaksioni adekuat dhe në kohën e duhur ndaj këtij lloj krimi është një ndër parakushtet e zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë.

Jetojmë në kohëra të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë kompjuterike ku format e sajber krimit përfshin fusha të shumta të jetës sonë të përditshme. Me sajber krimin kanë problem të gjithë, si vendet e pazhvilluara, ato në tranzicion, poashtu edhe shtetet me ekonomi të zhvilluar.

Nga paraqitja e formave të para të këtij lloji krimi deri në definimin final kaluan shumë vite, ku menjëherë pas saj doli fenomenii ri - sajber krimi. Format më të shpeshtuara të keqpërdorimit të kompjutorëve i shtyen ekspertët publik të meren me këtë lloj sjellje kriminale.

Megjithatë duhet të potencohet fakti se akoma nuk ekziston një definicion i qartë për sajber krimin.

Vështirësitë gjatë definimit të sajber krimit vijnë si rezultat i faktit që kemi të bëjmë me një fenomen relativisht të ri, por edhe për shkak të larmisë së këtij fenomeni, e cila shumë rëndë mund të përfshihet me një definicion të vetëm.

Duhet të bëhet dallim mes krimit kompjuterik edhe atij elektronik. Krimi kompjuterik i përfshin veprat që janë kryer me kompjuter, materialet në të (softueri dhe të dhënat) ku kompjuteri përdoret si mjet ose me qëllim të kryerjes së veprave penale.

Krimi kompjuterik përfshin, hyrjen në sistem tjetër kompjuterik, vjedhjen e të dhënave, ose shfrytëzimin e online sistemeve për kryerjen e mashtrimeve. Këtu hyjnë hakerimi, sulmii serviseve të mirëmbajtjes dhe funksionimit, shfrytëzimi paautorizuar i të dhënave dhe sajber vandalizmi. Ndërsa nga ana tjetër kriminaliteti elektronik përfshin aktivitetet kriminale të cilat kryhen nëpërmjet medimeve elektronike të komunikimit. Në kuptim më të zgjeruar krimielektronik dhe çdo aktivitet kriminal i cili kryhet me nëpërmjet kompjuterit ose sistemeve kompjuterike dhe rrjetet.⁴³

Në këtë kuptim, definimi më i plotë i këtij lloji të kriminaliteti do të ishte: „ ***Krimi sajber nënkupton formë të sjelljes kriminale, ku përdoren teknologji kompjuterike dhe sisteme informative si mënyre e kryerjes së veprave penale, ose kompjuteri përdoret si mjet për ekzekutim, me çka arrihet një pasojë relevante në kuptim juridiko-penal***”.⁴⁴

⁴³Drakulic, Mirjana, Drakulic, Ratimir, “Cyber kriminal”, Fakultet i shkencave organizative, Beograd, 2009, faq. 56

⁴⁴Bazuar në: Drakulic, Mirjana, Drakulic, Ratimir, “Cyber kriminal”, Fakultet i shkencave organizative, Beograd, 2009, faq. 56

KAPITULLI III

3. Krimii organizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut

3.1 Vëllimi dhe struktura e krimit të organizuar në teritorin e RMV

Krimi i organizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut manifestohet nëpërmjet veprimit të grupeve të organizuara kriminale (GOK) në nivel nacional dhe ndërkombëtar në një ose më shumë fusha kriminale me qëllim të përfitimit financiar dhe material. Në krimin e organizuar dhe serioz, GOK i shfrytëzon të gjitha resurset financiare që kanë në disponim, përdorin ekspert për fshehjen e aktiviteteve kriminale dhe në raste të caktuara shfrytëzojnë bizneset legale me qëllim të realizimit të qëllimeve kriminale dhe përfitimit material. Krimi i organizuar serioz përshtatet me rrethin ku vepron, të involvuarit përdorin kundërmasa për mbrojtje dhe risi në metodat e tyre me ndikim të matur në sektorin publik nëpërmjet aktiviteteve koruptive. Një ndër fushat kryesore kriminale ku veprojnë aktorët kriminal janë tregtia e paligjshme me drogë, kontrabanda e migrantëve, krimi kompjuterik, krimi pronësor, evazioni fiskal.⁴⁵

Grupet kriminale dallohen mes veti sipas numrit të anëtarëve, prejardhjes së anëtarëve dhe nuk karakterizohen me ndonjë hierarki të theksuar. Përveç grupeve që veprojnë kohë pas kohe, GOK të caktuara karakterizohen me kontinuitet në veprim të cilat bazohen në lidhjet farefisnore ose interesa kriminale. Një e treta e grupeve kriminale janë polikriminale, respektivisht veprojnë në më shumë fusha kriminale. Të shumtat e GOK nuk posedojnë fuqi të madhe financiare, të cilat në aktivitetin e tyre kriminal u japin mito zyrtarëve të korruptuar të niveleve më të ulta, me çka sigurojnë mbrojtje për aktivitetet e tyre kriminale. Për mbrojtjen përdorin masa të thjeshta tradicionale, shfrytëzojnë bizneset legale në aktivitetin kriminal, përderisa dhuna si dukuri përdoret në raste të izoluara në kuadër të grupit dhe jashtë tij. Kontrolli i aktiviteteve kriminalendodh vetëm tek disa GOK, përderisa aktivitetet kriminale tolerohen vetëm tek disa grupe etnike në rrethin ku jetojnë anëtarët e grupit, e cila manifestohet me injorimin e aktiviteteve kriminale.

⁴⁵Cvetanka ZATKOSKA, Viktorija KALLAPOCEVA - KURTOVIQ, Katerina KORUNOSKA – STOJANOVSKI, 2016, Vlerësimi i kërcënimit nga krimi serioz dhe i organizuar, Ministria e punëve të brendshme, Shkup

Tabela 2. Shkalla e krimit⁴⁶

Viti:	2005	2006	2007	2008	2009
SHKALLA E KRIMIT NË 100.000 BANORË	1113,60	1078,60	1282,20	1382,70	1331,40
Gjithsej Veprat penale	22.634	22.024	26.224	28.327	27.330
NUMRI I BANORËVE	2.032.544	2.041.941	2.045.177	2.048.619	2.052.722

Ne vazhdim në tabelë është paraqitur shkalla e krimit e treguar në vite nga 2005 deri 2009 në të cilën shihet një ngritje e numrit të krimeve në vitin 2008 në krahasim me vitin 2006 ku shkalla e krimit është më e ulët

3.2 Parandalimi i krimit të organizuar në RMV

Parandalimii krimit të organizuar serioz në masë të madhe varet nga njohja e pasqyrës së përgjithshme për këtë lloj krimi si dhe pasojat e veprimit të tij.

Vlerësimi, para së gjithash, do ju ndihmon vendimmarësve të vendimeve politike, të agjencioneve për implementimin e ligjit, si dhe për të gjithë pjesëmarrësit në zgjidhjen e sfidave në fushën e krimit të organizuar transnacional në kohën e globalizimit ku vijat kufitare nuk paraqësin asnjë pengesë për kriminelët.

⁴⁶<https://mvr.gov.mk/analiza/kriminal/16>

Njëkohësisht do të ndihmon në marrjen e nismave për veprim efikas kundër krimit të organizuar serioz në drejtim të parandalimit më të mire, intervenimit dhe bashkëpunimit, të siguron siguri në shtet, të rrit besimin në publik, dhe në mënyrë efektive të mbrohet shteti dhe qytetarët e saj nga pasojat e këtij lloj krimi.

Korniza juridike dhe institucionale është e vendosur ashtu, duke përfshi edhe Ligjin për procedure penale, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të luftimit të rasteve ku egziston krimi i organizuar kompleks dhe korupsion me përforsim të rolit të prokurorisë publike, krijimin e policies ligjore, duke i dhënë kahje fazes hetimore dhe teknikave hetimore. Poashtu egziston bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar, përmes Evrojustis dhe Europol. Konventa europiane për ndihmën e përbashkët për çështjet kriminale u nënshkrua në vitin 1999. Konventa e OKB kundër krimit të organizuar u nënshkrua në Dhjetor të viti 2000, u ratifikua në Janar të vitit 2005⁴⁷.

Deri më sot Maqedonia ka ratifikuar dhe nënshkruar: Konventën e OKB për tregtinë e paligjshme me narkotikë dhe substanca psikotropike, Konventën Medigra të OKB kundër korupsionit, Konventën e Këshillit të Evropës për larjen e parave, zbulimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga tregtia e paligjshme dhe Konventën e veprave penale kundër korupsionit. Në përgjithësi, vendi, bën reformat e vazhdueshme të cilat do të mundësojnë përdorimin e masave efektive të UE në fushën e krimit transnacional.

Korniza juridike e Republikës së Maqedonisë, bashkë me Kodin Penal dhe Ligjin për procedure penale, janë vendosur ashtuqë, për të përmirësuar kapacitetet e luftimit të rasteve të krimit të organizuar dhe korupsionit. Forcohet edhe roli i prokurorisë publike, krijohet policia ligjore, i jepet kahje procesit hetimor me teknikat e reja, me të cilat do të përmirsohet lufta kundër krimit të organizuar. Parimet e punës praktikë dhe zhvillimi i procedurës për ndjekjen e kryesve të ndojnë krimi të organizuar, janë të përfshira në Ligjin për procedure penale të RM. Kodi penal, në këtë drejtim, e inkriminon vet grupimin me qëllim të kryerjes së veprave penale (bashkimi kriminal, KP neni 394).⁴⁸

Përveç kësaj, KP përmban edhe shumë inkriminime ku parashihet dënueshmëria e krimit të organizuar në RM (larja e parave neni 273, tregtia me narkotik - neni 215, tregtia menjëherë -

⁴⁷Tuxharovska- Gjorgjievska E.Raporti mbi monitorimin e rreziqeve të korupsionit dhe krimit të organizuar,Projekt : Luftimi i korupsionit dhe krimit të organizuar.

⁴⁸KP i RM, neni 394.

neni 418 dhe 418-g, kontrabanda - neni 278, tregtia e paligjshme - neni 277 dhe të ngjashme). Vetë lufta kundër krimit të organizuar nuk është e koncipuar në një nenë të KP apo vetëm në një kapitull.

Prania e krimit pronësor në Republikën e Maqedonisë nuk dallon nga gjendja në rajon apo nga shtetet e Unionit Evropjan. Edhe pas rënies së dukshme të rasteve të regjistruara, përsërii njejt i përfaqësuar me rreth 70% nga krimi i përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë. Gjeografikisht, prania e delikteve pronësore në Republikën e Maqedonisë dallon në varësi prej madhësisë së qyteteve dhe banorëve, në nivele jashtëzakonisht të larta është i pranishëm në rajonin e qytetit të Shkupit.

Në Republikën e Maqedonisë, forma më e shpeshtë e zbuluar e krimit të organizuar, për të cilën është kryer procedura hetimore dhe është sjell vendim gjyqësor, është tregtia me qenie njerëzore. Pastaj bashkimi kriminal, prodhimi paligjshëm dhe tregtia me narkotikë. Vendim gjyqësor për vepra të lidhura me korupsion publik nuk janë aq të shpeshta.

Zgjidhje tjera ligjore të cilat kanë lidhje me shkatrimin e disa llojeve dhe nënlojeve të krimit të organizuar janë:

- **Ligji për kontrollimin e drogave dhe substancave psikotrope** – ndalohet kultivimi, prodhimi, shitja, ndermjetsimi dhe përdorimi i substancave dhe bimëve si dhe preparateve të tyre përveç për hulumtime qëllime mjekësore ose shkencore apo mjekësoro ligjore, edukative dhe për qëllime policore.
- **Ligji për armatim** prej vitit 2005 – definicionii armatimit, llojet e armatimit si dhe korniza ligjore për kushtet e furnizimit, posedimit, bartjes, ruajtjes, prodhimit, rregullimit, shitjes, transportit përmes pikave kufitare shtetërore të armëve dhe municion.
- **Ligji për dorëzim vullnetar dhe grumbullimin e armëve të zjarrit, municionit dhe materialeve eksplozive dhe legalizimin e armëve** vitit 2003 – qëllimi: arritja e stabilitetit kombëtar përmes çarmatimit dhe dorëzimit vullnetar të armatimit. Ligji garanton anonimitetin e qytetarëve të cilët dorëzojnë armatimin dhe se ndaj tyre nuk do të ketë asnjë lloj ndjekje apo procedure penale. Ligji parasheh edhe legalizimin e armëve përmes plotësimit të kërkesës për legalizim dhe me plotësimin e kushteve të parapara ligjore për marrje të lejes për armë⁴⁹.

- **Ligji për shkelje të qetësisë dhe rendit publik**

⁴⁹Kosevaliska O., Maksimova E., (2018), Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni (skript), Universiteti Goce Delcev-Shtip, Fakulteti Juridik, Shtip.

- **Ligjipër policinë**
- **Ligjipër gjykatat**
- **Ligjipër prokurorinë publike**
- **Ligji përparandalimin e larjes së parave dhe të ardhurave tjera të dënueshme si dhe financimii terorizmit**

Midis akteve nënligjore, relevante janë:

- **Rregullorja për llojet e armëve me të cilat mund të furnizohemi në bazë tëlejes dhe kuptimine e llojeve të caktuara të kategorisë A dhe D, e cila përmban definicion të qartë për ndarjen e armëve në kategori dhe radhitja taksative secilat armë cilit grup I përkasin.**
- **Rregullorja për mënyrëne bartjes së armëve dhe municionit permes pikave kufitare shtetërore,** përmban nene se në çfar mënyre është elejuara të futet arma në Republikën e Maqedonisë - permes pikave kufitare të rregulluara ku në vazhdimësi kakontrolle kufitare dhe gjatë së cilës qartë duhet të theksohet se dëshiron të futë armë dhe setë njejtën armë do tua jep për kontroll personave zyrtar bashkë me dokumentacionin e nevojshëm.
- **Rregullorja për kushtet minimale teknike të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet ku bëhet prodhimi dhe riparimi respektivisht lëshojnë në qarkullim dhe e ruajnë armatimin apo municionin,** i njejtë është sjellur në koordinim me Ministrinë e transportit dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe përmban dispozita të detajuara për hapësirat që duhet të posedojnë këto objekte, materialet dhe mënyrën si duhet të ndërtohen, si dhe mënyra e sigurimit dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore.

3.3 Roli dhe veprimii organeve kompetente në luftën kundër krimit të organizuar

-Roli i prokurorisë publike në luftën kundër krimit të organizuar

Për luftë të suksesshme kundër krimit të organizuar, në secilin shtet, është e nevojshme që të gjitha organet kompetente të kryejnë detyrat e tyre ligjore, pasi që bëhet fjalë për një formë shumë të rrezikshme të krimi ku nevojitet një veprim i koordinuar dhe i përbashkët me qëllim të arritjes së një efikasiteti sa më të lartë dhe shkatërrimin e të njejtë.

Të gjitha organet, nevojitet të japin kontributin e tyre në luftën kundër këtij lloji krimi.

Perveç policisë dhe prokurorisë publike institucione tjera të cilat japin kontribut të dukshëm në zbulimin dhe sigurimin e dëshmive kanë edhe Drejtoria e të hyrave publike, Drejtoria e Doganave dhe Agjencioni për kundrazbulim, si dhe organe tjera shtetërore.

Në pajtim me Ligjin për prokurori publike⁵⁰ Prokuroria publike është organ i vetëm shtetëror dhe i pavarur i cili ndjek aktorët e veprave penale dhe veprave të tjera të dënueshme me ligj si dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj. Prokuroria publike kryen funksionet e veta sipas Kushtetutës dhe ligjeve si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhshmëri me Kushtetutën. Funksionin e prokurorisë publike e kryejn prokurori publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokurorët publik. Prokuroria publike është e organizuar si Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë, Prokuroria e lartë publike, Prokuroria themelorepublike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korupsionit dhe Prokuroria themelorepublike. Prokuroria publike themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korupsionit, vepron pranë gjykatës themelore me repart të specializuar përgjegjëse për gjykimin e veprave nga fusha e krimit të organizuar.

Në realizimin e funksionit të ndjekjessë kryesve të veprave penale dhe kundërvajtjeve, prokurori publik: i ka autorizimet që i kanë Ministria e punëve të brendëshme dhe organet e tjera për zbulimin e veprave penale dhe kryerësve të tyre si dhe mbledhjene dëshmive për ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale, në procedurën parahetimore ka autorizim që të lëshoj urdhëra për aplikimin e masave të posaçme hetimore, e udhëheq procedurën parahetimore si dhe i ka në shërbim personat e autorizuar zyrtarë në Ministrinë e punëve të brendëshme, policinë Financiare si dhe drejtorinë e Doganave në përputhje me ligjin, mund vet të ndërmer çdo veprim të nevojshme për zbulimin e veprës penale si dhe zbulimin dhe ndjekjen e kryerësit të saj për të cilën me ligj është i autorizuar Ministria e punëve të brendëshme, policia Financiare si dhe drejtoria e Doganave; që të vendos për ndërmarrjen apo vazhdimin e ndjekjes penale për kryerësit e veprave penale, që të parashtrij dhe përfaqësoj aktakuzat para gjykatave, të deklaroj mjete juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme kundër vendimeve gjyqësore; të parashtrij kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes si dhe të kryej edhe veprime të tjera të parapara me ligj. Prokurori publik kryen edhe veprime të tjera të parapara me ligj për funksionimin efikas të sistemit juridiko-penal dhe parandalimin e krimit. Në rast të mosveprimit

⁵⁰Ligji është publikuar në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ numër 150 onga12.12.2007 vit.

nga ana e organeve të tjera shtetërore, prokurori publik mund ti ndërmer vet veprimet të cilat i kryejn personat e autorizuar në Ministrinë e punëve të brendëshme apo organet e tjera shtetërore⁵¹.

Në përputhje me nenin 31 nga ligji, prokuroria Themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korupsionit është e autorizuar që të procedoj:

- për vepra penale të kryera nga grup i strukturuar prej tre ose më shumë persona, i cili ekziston një periudhë të caktuar kohore dhe vepron me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave penale për të cilat është paraparë dënim me burg nga më së paku katër vjet, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të të mirave financiare apo lëvërdive të tjera, -për vepra penale të kryera nga grupi i strukturuar apo organizata keqbërëse në teritorin e Republikës së Maqedonisëapo në shtetet tjera ose kur vepra penale është përgatitur apo planifikuar në Republikën e Maqedonisë ose në shtetet tjera, -për veprat penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 33 paragrafi (5), mitmarrje me vlerë të konsiderueshme nga neni 357 dhe ndërmjetësimi joligjor nga neni 359 të gjitha nga Kodi penal, të kryera nga funksioneri i zgjedhur apo i emruar, personi zyrtarë apo personi përgjegjës në personin juridik dhe për vepra penale prodhimitari e pautorizuar dhe lëshimi në qarkullim e drogave narkotike, supstancave psikotrope dheprekursorëve nga neni 215 paragrafi (2), larja e parave si dhe të ardhurate tjera në shuma të mëdhaja që konsiderohen vepra penale nga neni 273, kërcenimi terrorist i rendit juridik dhe sigurisë nga neni 313, dhënia e mitos në shuma të konsiderueshme nga neni 358, ndikim kundërligjor mbi dëshmitarët nga neni 368-a paragrafi (3), bashkim për të kryer vepra kriminale nga neni 394, organizata terroriste nga neni 394-a, terorizmi nga neni 394-b, veprat penale kontrabandë me njerëz nga neni 418-a, veprat penale kontrabandë me migrantë nga neni 418-b, tregtia me persona të mitur nga neni 418-g si dhe për vepra të tjera penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga Kodi Penal, pavarësisht nga numri i kryersve.

Prokurori publik për çështjet e rëndësishme për realizimin e funksionit të ndjekjes, si dhe për çështjet e zbulimit të veprave penale dhe kryersve të tyre e udhëheq bashkëpunimin dhe i koordinon veprimet me organet tjera shtetërore dhe personat juridik.Për vepra penale për të cilat është përgjegjëse të veproj prokuroria Themelore publike për ndjekjen e kryersve të veprave

⁵¹„Ligji për prokurorinë publike”,Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2007, 111/2008.

penale nga fusha e krimit të organizuar dhe korupsionit, Ministria e punëve të brendëshme dhe organet tjera shtetërore janë të obliguar të informojnë prokurorin publik për të gjitha veprimet e ndërmara në procedurën parahetimore. Për realizimin e funksionit të ndjekjes së veprave penale në fushën e krimit të organizuar dhe korupsionit dhe për vepra të tjera penale për të cilat është paraparë dënimi minimal me burg prej katër vitesh ose kur atë e kërkojnë kushtet e veçanta, prokurori publik mund të urdhëroj një apo më shumë konkretisht të përcaktuar persona të autorizuar zyrtar nga Ministria e punëve të brendëshme dhe organet tjera shtetërore që të jenë në dispozicion të tij për një periudhë të caktuar, si në procedurën para hetimore, ashtu edhe në procedurën penale e cila udhëhiqet në bazë të kërkesës së tij.

Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë në kuadër të marëveshjeve ndërkombëtare, realizon bashkëpunim të dretëpërdrejt me prokurorit publike nga shtetet tjera, veçanërisht në planin e parandalimit dhe ndjekjen e krimit të organizuar dhe formave të tjera të rënda të krimit nëpërmjet shkëmbimit të drjtëpërdrejtë të të dhënave, bashkëpunimit të drejtëpërdrejtë, edukimit, specializimit të kuadrit si dhe forma të tjera të bashkëpunimit.

-Roli i policisë në luftën kundër krimit të organizuar

Në pajtim me Ligjin për policinë⁵², Policia është pjesë e Ministrisë së punëve të brendëshme, në të cilën kryen punët policore nëpërmjet nëpunësve policorë. Funkzioni bazë i policisë është mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, mbrojtja e rendit juridik, parandalimi dhe zbulimi i veprave të dënueshme, marja e masave për ndjekjen e kryesve të atyre veprave, si dhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike në shoqëri. Për kryerjen e punëve policore për të cilat është e nevojshme shkallë e lartë e specializimit, për kryerjen e detyrave të caktuara specifike dhe të vështiranë mënyrë efektive dhe ekonomike, si dhe për nevojat e sektorëve për punë të brendëshme dhe qendrave rajonale për veprimtari kufitare, në bazë të principit të veprimtarive të centralizuara, formohen njesi Qendrore policore, të cilët detyrat i kryejnë në tërë teritorin e Republikës së Maqedonisë. Shërbimet Qendrore policore i kryejnë punët në fushën e krimit të organizuar, teknikës kriminalistike, punët në dhënien e përkrahjes në kryerjen e punëve specifike dhe të ndërlikuara në rajonet e sektorëve

⁵²Ligji për policinë (teksti i pastruar), Shkup, mars 2015.

për punë të brendëshme dhe qendrat rajonale për punë kufitare nga ana e njesive të posaçme të Policisë, si dhe punë dhe detyra të tjera.

Në shërbimet Qendore policore, funksionon Reparti për krimin e organizuar për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale për të cilat ndjekja fillon sipas detyrës zyrtare, të kryera nga grupi i organizuar nga më së paku tre persona, e cila vepron një periudh të caktuar, me qëllim tërealizimit të lëvërdisësë drejtpërdrejt apo të tërthortë financiare apo llojë tjetër të përfitimit material dhe e cila do të kryejë një apo më shumë vepra penale, si dhe për vepra të tjera penale për të cilat me ligj është paraparë dënimi me burgë në kohëzgjatje prej më së paku katër vitesh⁵³.

Reparti i kryen detyrat edhe për zbulimin dhe parandalimin e veprave penale të cilat sipas natyrës së tyre janë transnacionale, si dhe për zbulimin e grupeve të organizuara të cilat përdorin dhunë dhe lloje të tjera të presionit, kyqen në aktivitetet legale ekonomike dhe me veprimtaritë koruptive, krijojnë kushte për realizimin sa më të lehtë të përfitimit dhe mbrojtjen nga ndjekja penale. Reparti në realizimin e punëve të veta bashkëpunon dhe i zbaton kahjet e dhëna nga ana e prokurorit publik, në përputhje me ligjin. Reparti gjatë kryerjes së detyrave të veta merë përkrahje në burime materiale dhe njerzore nga sektorët për punë të brendëshme dhe nga qendrat rajonale për punë kufitare.

- Gjykata për krimin e organizuar

Në sistemin gjyqësor pushtetin gjyqësor e kryejnë gjykatat themelore, gjykatat e apelit, gjykata Administrative, gjykata e Lartë administrative dhe gjykata e Lartë e Republikës së Maqedonisë. Në gjykatën Themelore – Shkup I,⁵⁴ formohet reparti i specializuar gjyqësor përgjegjëse për gjykimin e veprave nga fusha e krimit të organizuar dhe korupsionit për gjith territorin e Republikës së Maqedonisë.

- Policia financiare⁵⁵

Punët në policinë Finnciare i kryen drejtoria e policisë financiare,e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së financave,në rolin e personit juridik. Në kudër të përgjegjësive, policia

⁵³Ligji për policinë (teksti i pastruar), Shkup, mars 2015.

⁵⁴Neni 32 nga Ligji për gjykatat, Gazeta zyrtare e RM nr. 58/06, 62/06, 35/08, 74/08, 118/08

⁵⁵Ligji për policinë financiare, Gazeta zyrtare e RM nr.55/07

financiare mund të kryej kontrole financiare, ta ndjek ndryshimin e rregullativës tatimore, doganore nga fusha e finansave, të mbledh dhe analizojë të dhëna për transaksionet financiare, të ndërmer masa parahetimore dhe masa të tjera kur ekziston dyshimi për kryerjen e veprave penale nga fusha e krimit të organizuar financiar, e ndjek gjurmën e parasë nga vepra të dënushme të përcaktuara me ligj të cilat përfshijnë shuma të konsiderueshme me përmasa të mëdha, zbulon dhe dokumenton vepra penale, siç janë larja e parave, fshehja tatimore, mashtrimet bankare, të sigurimit dhe doganore, forma të rënda të korupcionit dhe të ngjajshme, zbaton procedura për kontrollin e pronës dhe gjendjes pronësore, parashtron fletparaqitje penale deri te prokurori publik për veprat që janë përgjegjësi e saj, paraqet iniciativë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes dhe të ngjajshme.

- ***Drejtori për kundërzbulim financiar***

Drejtorja për kundërzbulimin financiar⁵⁶ funksionon nga marsi i vitit 2002 si organ në kuadër të Ministrisë së finansave. Gjatë këtyre viteve, institucioni dy herë e ka ndryshuar emrin e vet, nga Departamenti për parandalimin e larjes së parave në Drejtori për parandalimin e larjes së parave dhe finansimin e terrorizmit, dhe pastaj e merë edhe emrin e ditëve të sodit Drejtorja për kundërzbulim financiar. Drejtorja, ndërkohë i ka forcuar kapacitetet e veta kadrovike dhe teknike, duke i zgjeruar përgjegjësitë e veta me çka është forcuar edhe statusi si organ në rolin e personit juridik. Ky institucion funksionon si njësi për kundërzbulim financiar, me përgjegjësi bazike për të mbledhur, përpunuar dhe dorëzuar të dhënat me qëllim të parandalimit të larjes së parave dhe finansimit të terrorizmit. Si partnere të Drejtorisë në realizimin e funksioneve themelore janë subjektet nga njëra anë dhe organet e hetuesisë nga ana tjetër.

Siç rrjedh nga përgjegjësitë e këtyre organeve shtetërore, ata duhet që vazhdimisht dhe syçelë të ndjekin se çka ndodh në teren, si dhe të ketë komunikim të vazhdueshëm dhe shkëmbim të informatave ndërmjet të njëjtëve, me qëllim që tëmund sa më lehtë të zbulohet, dhe pastaj edhe të çrrënjoset krimi i organizuar.

⁵⁶<http://www.ufr.gov.mk/?q=node/4> (është kyqur më 08.03.2019)

KAPITULLI IV

4. Hulimtimi i rastit – Bisedat e përgjuara në periudhën prej vitit 2014 – 2018 në RMV

4.1 Kuptimi për ndjekjen e komunikimeve

Ndjekja e komunikimeve realizohet sipas kushteve të përcaktuara me *Ligjin për ndjekjen e komunikimeve*⁵⁷ dhe *Ligji mbi procedurën penale*⁵⁸ dhe atë në mënyrën dhe procedurën me të cilën nuk rezikohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Ndjekja e komunikimeve mund të zgjatë vetëm një kohë të caktuar, e cila është e nevojshme për mbledhjen e të dhënave për arritjen e qëllimieve të ndjekjes.

Për arsye të kuptimit të plotë të termave është e nevojshme definimi i tyre:

- **Komunikimi** – çdo bisedë e drjtpërdrejtë dhe çdo transmetim i zërit të njeriut, të shenjave, sinjaleve, teksteve të shkruara, fotografive, zërit, bazavetë të dhënave apo informacioneve të çdo lloji natyre;
- **Ndjekja e komunikimeve** – zbulimi i fshehtë i përmbajtjes së silit do qoftë komunikim në mes të njerëzve dhe njëkohësisht krijimi i regjistrimit teknik për përmbajtjen e komunikimeve, me mundësi të riprodhimit.

Pa urdhërin e gjykatës përkatëse askush nuk duhet të bëjë ndjekjen e komunikimeve, përveç nëse është i destinuar apo ka pëlqim nga personi apo personat të cilët janë kyçur në komunikimin⁵⁹.

Masën për ndjekjen e komunikimeve, pas arsyetimit të kërkesës së prokurorit publik e përcakton gjykatësi në procedurën paraprake në formë të urdhërit me shkrim. Këtë masë e realizon prokurori publik ose policia gjyqësore nën kontrollin e prokurorit publik. Gjatë realizimit të masave policia gjyqësore përgatit raport të cilin e dorzon deri te prokurori publik me kërkesë të tij.

⁵⁷Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 71 nga 19.4.2018 vit.

⁵⁸Ligji për procedurën penale, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 150 nga 18.11.2010 vit.

⁵⁹Po aty.

Të gjitha të dhënat e fituara, informatat, dokumentet dhe lëndëte mara me zbatimin e kësaj mase, nën kushte dhe mënyra të përcaktuara me Ligjin për procedur penale, mund të përdoren si dëshmi në procedurën penale.

Masa për ndjekjen e komunikimeve mund të zgjatë më së shumti katër muaj. Vazhdimi i masës më së shumti edhe për katër muaj mund ta aprovoj gjykatësi në procedurën paraprake, por pas kërkesës së arsyetuar me shkrim nga prokurori publik.

Kur do të arrihen qëllimet për të cilat janë marë masat e veçanta hetuese apo do të përfundojnë së ekzistuari qëllimet për të cilët janë lejuar, organi i cili e ka lëshuar apo e ka vazhduar urdhërin është i obliguar që menjëherë të urdhërojë ndërprerjen e masave. Nëse prokurori publik dorëzohet ose heq dorë nga ndjekja penale apo nëse të dhënat e mbledhura me masat të posaçme hetuese nuk kanë rëndësi për vazhdimin e procedurës, ato do të asgjësohen nën mbikqyrjen e gjykatësit, për të cilin prokurori publik do të përpilojë procesverbal.

Pas ndërprerjes së masave të posaçme hetuese, nëse ajo nuk pengon në procedurë, pas kërkesës së personit të interesuar, prokurori publik do ti dorëzoj urdhërin me shkrim. Personi i cili në çfarë do lloj mënyre zbulontë dhëna të cilat kanë të bëjnë apo rrjedhin nga zbatimi i masave të posaçme hetuese është i obliguar ti ruaj ato si fshehtësi zyrtare.

Nëse në afat prej 15 muajsh pas përfundimit të zbatimit të masës nuk ngrihet procedur penale, të gjitha të dhënat personale të mbledhura fshihen apo asgjësohen nën mbikqyrjen e gjykatësit në procedur paraprake, prokurorit publik dhe përfaqësuesit të Departamentit për mbrojtjen e të dhënave personale për të cilën prokurori publik do të përpiloj procesverbal⁶⁰.


Masa mundë të drejtohet vetëm në drejtim të të dyshuarit dhe të zbatohet vetëm në shtëpinë e të dyshuarit. Masa është e lejuar edhe në shtëpinë e personave të tjerë vetëm në qoftë se ka dyshime të bazuara se aty qendron i dyshuari. Inçizimi do të ndërpritet nëse gjatë inçizimit ekzistojnë tregues se do të zbulohen deklarata të cilat bëjnë pjesë në sferat bazike të jetës private dhe familjare. Dokumentacioni për deklaratat e tilla duhet menjëher të asgjësohet.

Nëse të dhënat e mbledhura për ndjekjen e komunikimeve, deri në sjelljen e vendimit për zbatimin e hetimit apo të dhënave të cilat janë asgjësuar shpallen në publik, qytetari i cili përshkak të saj ka pësuar dëme ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore dhe kompensim të demit. Personi komunikimi i të cilit është ndjekur ka të drejtë ta kontestoj autenticitetin e të dhënave të

⁶⁰Ligji për procedur penale, Gazeta Zyrtare e RM nr. 150 datë 18.11.2010.

mbledhura dhe ligjshmërinë e procedurës për ndjekjen e komunikimeve të tija, në procedurë të përcaktuar me Ligjin për procedurën penale të Republikës së Maqedonisë.

Sipas Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, ai i cili me përdorimin e pajisjeve të posaçme në mënyrë të paautorizuar përgjon apo inçizon me zë bisedën apo deklaratën e cila nuk i është drejtuar atij, do të dënohet me dënim financiar ose me burg deri një vit, dhe nëse përgjimin e paautorizuar dhe inçizimin me zë e ka kryer personi zyrtarë atëherë është paraparë dënim me burg nga 3 muaj deri 3 vite. Do të dënohet edhe ai i cili do ti mundësoj personit të paautorizuar që të dëgjoj bisedën apo deklaratën e cila është përgjuar apo inçizuar me zë.⁶¹



Fotografia 1. Pajisje dhe instrumente për ndjekjen e komunikimeve

4.2 Procedura për ndjekjen e komunikimeve për zbulimin dhe ndjekjen kryesve të veprave penale në fushën e krimit të organizuar

Kërkesa për sjelljen e urdhrin për ndjekjen e komunikimeve, deri te gjykatësi përgjegjës e dorzon prokurori publik kompetent me vetëiniciativë ose me propozim të zyrtarit policor të Ministrisë së punëve të brendshme gjegjësisht pjesëtarit të Drejtorisë së policisë financiare gjegjësisht me personin e autorizuar me ligj nga Drejtoria doganore i cili e udhëheq rastin⁶².

Kërkesa për ndjekjen e komunikimeve dorzohet deri te gjykatësi në procedurë paraprake në formë të shkruar dhe përmbanë:

⁶¹Kodi penal (teksti i pastruar integra) 132/14, Shkup

⁶²Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM nr. 71 i 19.4.2018.

- emërtimin ligjor të veprës penale;
- personat apo objektet mbi të cilat do të zbatohet masa e posaçme hetimore ndjekja e komunikimeve;
- mjetetet teknike të cilat do të zbatohen;
- përmasat dhe vendin e zbatimit të masave të posaçme hetimore për ndjekjen e komunikimeve;
- njohuritë dhe dëshmitë në bazë të së cilëskrijohen bazat e dyshimit dhe arsytimit për shkaqet për të cilat të dhënat apo dëshmitë nuk mundë të mblidhen në mënyra tjera;
- organin i cili duhet ta zbatoj urdhërin;
- kohëzgjatjen e masës së posaçme hetimore për ndjekjen e komunikimeve dhe
- llojin e sistemit të telekomunikacionit, numrin e telefonit apo të dhëna tjera për identifikimin e kyçjes së telekomunikacionit.

Për kërkesën për ndjekjen e komunikimeve gjykatësi në procedurën paraprake vendos më së voni në afat prej 48 orësh nga parashtrimi i kërkesës. Nësa gjykatësi në procedurën paraprake nuk pajtohet me kërkesën për ndjekjen e komunikimeve, procedohet në bazë të dispozitave të Ligjit për procedur penale të cilën janë regulluar procedurat në rastet kur gjykatësi në procedur paraprake nuk pajtohet me propozimin e prokurorit publik.

Në përjashtim, nga neni 11 të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve,⁶³ në rastet urgjente, kur ekziston rrezik nga shkaktimi i dëmit të pakompensueshëm për udhëheqjen e suksesshme të procedurës penale, gjykatësi në procedur paraprake mund të jep urdhër gojor me të cilën do të lejoj ndjekjen e komunikimeve në kohëzgjatje prej 48 orësh, në bazë të kërkesës së parashtruar në mënyrë gojore për ndjekjen e komunikimeve nga ana e prokurorit të publik të autorizuar.

Për parashtrimin e kërkesës gojore për ndjekjen e komunikimeve nga prokurori publik i autorizuar dhe lëshimin e urdhërit gojor, gjykatësi në procedure paraprake përpilon shënim zyrtarë, i cili evidentohet në regjistrin e gjykatës.

Për parashtrimin e kërkesës gojore për ndjekjen e komunikimeve dhe lëshimin e urdhërit gojor, prokurori publik i autorizuar:

- menjëher e informon nëpunësin policorë të Ministrisë së punëve të brendëshme

⁶³Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 71 nga 19.4.2018 vit, neni 11

gjegjësisht pjestarin nga Drejtoria e policies financiare gjegjësisht personin e autorizuar me ligjë të Drejtorisë së Doganave i cili e udhëheq rastin, për zbatimin e urdhërit gojor, në rast kur ndjekja e komunikimeve kryhet nga ana e Ministrisë së punëve të brendëshme, Drejtorisë së policisë financiare ose Drejtorisë së Doganave;

- përpilon shënim zyrtarë dhe
- menjëher, dhe më së voni në afat prej 24 orësh pas marjes së urdhërit gojor, dorzon kërkesë deri te gjykatësi në procedur paraprake, në pajtim me nenin 10 të vet ligjit.

Nëpunësi policor nga Ministrisë së punëve të brendëshme gjegjësisht pjestari nga Drejtoria e policies financiare gjegjësisht personi i autorizuar me ligjëi Drejtorisë së Doganave i cili e udhëheq rastin, në bazë të lajmërimit të pranuar gojor nga prokurori publik i autorizuar, për zbatimin e urdhrit të dhënë gojor, përgatitë shënim zyrtarë dhe menjëher ndërmer masa për zbatimin e urdhërit.

Me urdhërin për ndjekjen e komunikimeve nga paragrafi 5 i këtij neni, gjykata do të lejoj ndjekjen e komunikimeve në kohëzgjatjen e nevojshme, por jo më shumë se katër muaj, duke marë parasysh edhe kohën prej 48 orësh për të cilën është lëshuar urdhëri gojor. Nëse në afat orej 24 orësh nga urdhëri i dhënë gojor, prokurori publik i autorizuar nuk dorzon kërkesë me shkrim deri te gjykatësi në procedure paraprake, do të konsiderohet se nuk është dhënë urdhri për ndjekjen e komunikimeve, të cilën e konstaton gjykatësi në shënimin zyrtarë.

Në rastin kur prokurori publik i autorizuar propozon vazhdimin e afatit të ndjekjes së komunikimeve para përfundimit të afatit të saj, gjykatësi në procedurën paraprake mundet, para përfunimit të afati të sjellë urdhër për vazhdimin e afatit për ndjekjen e komunikimeve, për një periudhë jo më shumë se katër muaj nga dita e përfundimit të afatit, për të cilën kërkohet vazhdimi.

Në rastet kur ndjekja e komunikimeve bëhet nga ana e Ministrisë së punëve të brendëshme, Drejtorisë së policies financiare apo Drejtorisë së Doganave, prokurorit publik i autorizuar urdhërin e lëshuar ja dorzon nëpunësit policor të Ministrisë së punëve të brendëshme gjegjësisht pjestarit të Drejtorisë së policisë financiare gjegjësishtë personit të autorizuar me ligj të Drejtorisë së Doganave i cili e udhëheq rastin. Gjatë kohës së zbatimit të urdhërit për ndjekjen e komunikimeve, prokurori i autorizuar publik vazhdimisht i ndjek veprimet të cilat ndërmerren në lidhje me zbatimin e urdhërit dhe kontrollon të gjitha të dhënat, dokumentacionin dhe materialet e tjera të mbledhura gjatë zbatimit të urdhërit.

Nëse të dhënat e mbledhura gjatë ndjekjes së komunikimeve, apo të dhënat të cilat janë asgjësuar dalin në publik, qytetari i cili për shkakë të saj ka pësuar dëmë ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore. Mjetet për kompensimin e dëmeve sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Të dhënat e mbledhura gjatë ndjekjes së komunikimeve nuk mund të përdoren si dëshmi në procedur penale, në rastet kur ndjekja është kryer në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me ligjë, si dhe kur ndjekja nuk është kryer në përputhje me dispozitat nga Ligji për procedurë penale.

4.3 Procedura për ndjekjen e komunikimeve për arsye të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit

Në lidhje me këtë rast gjykata mundë të urdhëroj ndjekjen e komunikimeve kur ekzistojnë bazat e dyshimit se përgatitet kryerja e veprës penale kundër shtetit, kundër forcave të armatosura apo kundër njerzimit dhe së drejtës ndërkombëtare.

Përveç në rastet nga paragrafi 1 i nenit 29 nga Ligji për ndjekjen e komunikimeve,⁶⁴ gjykata mund të urdhërojë ndjekjen e komunikimeve edhe kur përgatitet, nxitet, organizohet apo meret pjesë në sulmin e armatosur kundër Republikës së Maqedonisë apo në asgjësimin e sistemit të saj të sigurisë që të mund zbatoj funksionet e veta, kur në mënyra të tjera nuk mundë të sigurohen të dhëna për aktivitete të tilla apo sigurimi i tyre do të bëhej me vështirësi të mëdha për të parandaluar kryerjen e veprës penale, sulmin e armatosur apo asgjësimin e sistemit të sigurisë.

Kërkesa për sjelljen e urdhërit për ndjekjen e komunikimeve në bazë të nenit 29 të këtij ligji mund të parshtrij ministri i punëve të brendëshme apo personi i autorizuar nga ai, si dhe ministri i mbrojtjes apo personi i autorizuar nga ai. Kërkesa për ndjekjen e komunikimeve dorzohet deri te Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë. Prokurori publik kërkesën për ndjekjen e komunikimeve e dorzon deri te gjykatësi i Gjykatës së lartë të Republikës së Maqedonisë, i caktuar në bazë të radhitjes së brendëshme të gjykatës.

Gjykatësi i gjykatës së lartë do të sjell urdhër për ndjekjen e komunikimeve në rastë se në kërkesë në bazë të fakteve dhe rethanave e vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore. Nëse gjykatësi nuk pajtohet për sjelljen e urdhërit për ndjekjen e komunikimeve, ai me shkrimë do ta lajmëroj parashtruesin në afat prej 24 orësh nga parashtrimi i kërkesës. Me urdhërin për

⁶⁴Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 71 nga 19.4.2018 vit.

ndjekjene e komunikimeve, gjykatësi i gjykatës së Lartë do të lejoj ndjekjen e komunikimeve për periudhën që është patjetër e nevojshme, por jo më shumë se gjashtë muaj.

Të dhënat e mbledhura për personin gjatë zbatimit të urdhërit për ndjekjen e komunikimeve ruhen në Ministrinë e punëve të brendëshme, përkatësisht në Ministrinë e mbrojtjes me regjim të posaçëm, më së shumti pesë vite pas kalimit të afatit të caktuar me urdhër. Pas kalimit të afatit, të gjitha të dhënat dhe materialet në lidhje me zbatimin e urdhërit për ndjekjen e komunikimeve asgjesohen nën mbikqyrjen e gjykatësit i cili e ka sjell urdhërin, gjithashtu për asgjesimin përpilohet procesverbali në të cilin regjistrohet vetën numri i urdhërit gjyqësor. Njëkohësisht, në regjistrin gjyqësor asgjesohen të gjitha të dhënat për personin për të cilin ka të bëjë urdhëri.

Procesverbali përpilohet në dy shembuj, nga të cilat nga një shembull për gjykatën dhe për parashtruesin e kërkesës për ndjekjen e komunikimeve.

4.4 Bisedat e përgjuara në periudhën prej vitit 2014-2018 në RM

Opozita politike në atë kohë në krye me Zoran Zaev zbuloi një numër të madh të bisedave të përgjuara të ashtuquajtura „bomba” të cilat u zbardhën dhe u nxorën para publikut, gazetarëve dhe medimeve sociale në formë të dokumentit, transkriptit, por edhe të audio inçizimeve të përfaqësuesve kryesor politik të cilët në atë kohë ishin në pushtet siç janë: Nikolla Gruevski, Gordana Jankulovska, Zoran Stavreski, Mille Janakieski, Sasho Mijallkov dhe shumë të tjerë në periudhën prej vitit 2014-2018, përshkakë se janë nxjerr dhe zbuluar një nga një. Bomba e parë është nxjerr para publikut më date 09.02.2015 vit. dhe quhej „Duhet të dihet se kush është pushteti!”, kurse e fundit më date 16.06.2015 vit dhe quhej Pazari (Tregu) „Çairi dhe Tetova”. Për këta biseda të përgjuara dhe hetimin e tyre të më tutjeshëm dhe procedurës hetimore, është formuar edhe prokuroria Speciale publike, e cila përgjigjet para publikut dhe gjithashtu udhëhiqet sipas ligjit dhe rregullativës ligjore.

Do ti përmendim disa nga bisedat e përgjuara me emërtimin dhe datën e shpalljes, ata janë si në vijim:⁶⁵

⁶⁵<http://prizma.birn.eu.com>

1. Bisedat e përgjuara – set 1: „Duhet të dihet se kush është pushteti!”, Konferenca për shtyp - 09.02.2015
2. Bisedat e përgjuara – set 2: Xhokeri në gjyqësor - „Është njeriu jonë?”, Konferenca për shtyp - 15.02.2015
3. Bisedat e përgjuara – set 3: Si ishte arrestuar Lube Boshkoski, Konferenca për shtyp - 20.02.2015
4. Bisedat e përgjuara – set 4:Komunistët, gazetarët dhe dokumentarët për luftën maqedonase, Konferenca për shtyp - 25.02.2015
5. Bisedat e përgjuara – set 6:„ Ne jemi të çmendur. Ne shpenzojmë në çokollata por nuk kemi buk në shpi.”, Konferenca për shtyp - 02.03.2015
6. Bisedat e përgjuara – set 7:Votuesit e rrejshëm, presionet dhe kërcënimet ndaj qytetarëve dhe ndërmarrjeve, Konferenca për shtyp - 06.03.2015
7. Bisedat e përgjuara – set 8: Keqpërdorimi i institucioneve shtetërore, Konferenca për shtyp - 10.03.2015
8. Bisedat e përgjuara – set 9: Komuna Qendër, Konferenca për shtyp - 12.03.2015
9. Bisedat e përgjuara – set 10: Pllacet (Tokat) e Kryeministrit, Konferenca për shtyp - 15.03.2015
10. Bisedat e përgjuara – set 11: Ndonjë fletë le të zhduket!, Konferenca për shtyp - 18.03.2015
11. Bisedat e përgjuara – set 12: Korupsioni në gjyqësor, Konferenca për shtyp - 19.03.2015
12. Bisedat e përgjuara – set 13: Pllacet (Tokat) e Kryeministrit 2, Konferenca për shtyp - 23.03.2015
13. Bisedat e përgjuara – set 14:Negociatatme„të verdhërit”, Konferenca për shtyp - 26.03.2015
14. Bisedat e përgjuara – set 15: Paisjet nga Izraeli, Konferenca për shtyp - 01.04.2015
15. Bisedat e përgjuara – set 16: Përgatitja e Kumanovës, Konferenca për shtyp - 02.04.2015
16. Bisedat e përgjuara – set 17: Bisedat e Prilepit, Konferenca për shtyp - 04.04.2015
17. Bisedat e përgjuara – set 18:Indijanët në Kuvend, Konferenca për shtyp - 06.04.2015
18. Bisedat e përgjuara – set 19: Programi nuklear Maqedonas dhe punësimet partiake, Konferenca për shtyp - 08.04.2015

19. Bisedat e përgjuara – set 20: Kryeministri punëson „tëparapëlqyerit”, Konferenca për shtyp - 14.04.2015
20. Bisedat e përgjuara – set 21: Krimet e Ohrit, Konferenca për shtyp - 16.04.2015
21. Bisedat e përgjuara – set 22: Fshehja e pronës dhe zbulimi i urrejtjes, Konferenca për shtyp - 18.04.2015
22. Bisedat e përgjuara – set 23: „Dill” i Barokut, Konferenca për shtyp - 19.04.2015
23. Bisedat e përgjuara – set 24: „Bomba” gazetareske, Konferenca për shtyp - 22.04.2015
24. Bisedat e përgjuara – set 25: Qeni policor nuk dallon partitë, Konferenca për shtyp - 23.04.2015
25. Bisedat e përgjuara – set 26: Tregëtia me vota, Konferenca për shtyp - 25.04.2015
26. Bisedat e përgjuara – set 27: Mbikqyrja e DSK, Konferenca për shtyp - 28.04.2015
27. Bisedat e përgjuara – set 28: DSK/SGS, Konferenca për shtyp - 30.04.2015
28. Bisedat e përgjuara – set 29: Vrasja e Martinit, Konferenca për shtyp - 05.05.2015
29. Bisedat e përgjuara – set 30: Nikolla Mlladenov, Konferenca për shtyp - 07.05.2015
30. Bisedat e përgjuara – set 31: Mercedesi i ri për Kryeministrin, Konferenca për shtyp - 13.05.2015
31. Bisedat e përgjuara – set 32: Punët e Vmros, Konferenca për shtyp - 15.05.2015
32. Bisedat e përgjuara – set 33: Negociatat për emrin, Konferenca për shtyp - 16.05.2015
33. Bisedat e përgjuara – set 34: Dill orientid, Konferenca për shtyp - 27.05.2015
34. Bisedat e përgjuara – set 30: Barokizimi i Shkupit, Konferenca për shtyp - 29.05.2015
35. Bisedat e përgjuara – set 30: Çështja banesore e ministrës, Konferenca për shtyp - 31.05.2015
36. Bisedat e përgjuara – set 30: Bomba e cila eksplodoi heshtur, Konferenca për shtyp - 08.06.2015
37. Bisedat e përgjuara – set 30: Pazari (Tregu) „Çairi dhe Tetova”, Konferenca për shtyp - 16.06.2015

Sipas LSDM, Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim (DSK), në mënyrë të paligjshme ka përgjuar përfaqësues të lartë nga pushteti dhe nga opozita, gazetarë, përfaqësues nga organizatat joqeveritare, nga Sinodi i KOM, BFI, politikan nga blloku shqiptar dhe të tjerë. Zoran Zaev pretendonte se është përgjuar katër vjetë, në vazhdimësi. Ai deklaroi se posedon inçizime nga mbi 300 biseda telefonike, kurse deri te prokuroria kanë dorzuar dëshmi prej 204 faqesh nga

transkriptet e bisedave. LSDM parashtori në atë kohë padi penale kundër Sasho Mijallkov, Goran Gruevski, kryeshefit të drejtorisë së pestë dhe kundër personave të tjerë të panjohur. Partia deklaroi se nuk pret përfundim ligjor, por beson se paraqitja e rasteve është detyrë e tyre.

Gjykata Administrative në Shkup vendosi që bisedat e përgjuara të mundë të përdoren edhe si dëshmi në procedurën gjyqësore për lëndën „Titanik 2” të PSP.

Në vitin 2018 raporti më i ri gjashtë muaj të cilin e shpalli Prokuroria Speciale Publike shkruan se në procedurën paraprake ka kapur njëqindë mijë inçizime të reja nga bisedat e përgjuara, jashtë atyre 606.555 të cilat ja kanë dorzuar LSDM.⁶⁶

„Kjo Prokurori Publike gjithashtu është në procesin e analizimit të më shumë se 100.000 audio fajlleve të cilat janë marrë gjatë kontrollit të realizuar tek disa persona dhe në vijim është përcaktimi se sa janë në numër dhe a parfaqësojnë këta audio fajlle objektin e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve”, theksohet në raportin për punën e PSP e cila ka të bëjë për periudhën nga 15. Shtatori 2017 deri 15 mars të vitit 2018

Nga të vjetrat, deri në vitin 2018 janë përgjuar 515.572 audio fajlle, apo 85% nga numri i përgjithshëm të audio fajlleve me të cilat disponon prokuroria, gjatë së cilës janë përpunuar 1.784 transkripte me indikacionin për *vepërën e kryer penale*.

PSP në periudhën prej gjashtë muaj ka hapur 136 lëndë të reja parahetimore. Nga ato 23 lëndë janë formuar me vetë iniciativë, kurse 113 lëndë janë formuar në bazë të paraqitjes nga parashtrues të tjerë.

Duke përfshirë paraprakishtë 99 procedura të hapura aktive parahetimore në këtë Prokurori publike për momentin janë në procesë gjithsej 235 procedura parahetimore. Nga ky numër i procedurave parahetimore janë zgjidhur gjithsej 53 lëndë. Në procesë janë gjithsej 182 lëndë.

Këta procedura të hapura parahetimore, shkruan në raport, kanë të bëjnë me: *ndjekjen e paligjshme të komunikimeve, si dhe për paligjshmërinë në lidhje me financimin e mediumeve, lloje të ndryshme të keqpërdorimeve në procedurat për furnizime publike, larjen e parave, veprimtari të ndryshme koruptive si dhe keqpërdorime të ndryshme të pozitës zyrtare dhe autorizimit dhe hetime financiare*.

⁶⁶<https://sdk.mk/index.php/makedonija/katitsa-ima-ushte-100-000-novi-snimki/>

Në këtë periudhë PSP ka ndërmarë procedura parahetimore nga PTHP Shkup si dhe nga PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korupcionit për rastet: SHKUPI 2014, AKTOR, lënda për objektin KOSMOS dhe lëndët për REGJISTRIMIN e popullatës në vitin 2011. Përgjatë periudhës së raportit të pestë, janë hapur gjithsej 7 procedura të reja hetimore kundër gjithsej 17 persona.

4.5 Formimi i Prokurorisë Publike - PSP

Prokuroria publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjeve të paligjëshme të komunikimeve, e njohur edhe si Prokuroria Speciale Publike, është formuar me Ligjin për Prokurorinë Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjëshme të komunikimeve, të miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë më 15 shtator të vitit 2015 dhe zgjedhjen e Katica Janeva për Prokuror publik e cila udhëheq me këtë Prokurori Publike.

Nevoja për formimin e Prokurorisë publike vjenë me publikimin e bisedave nga ndjekja e paligjëshme e komunikimeve në vitin 2015, të cilat zbuluan probleme sitemore në fushën e sundimit të së drejtës, të cilat u vërtetuan me Raportin e Pribes dhe prioriteteve urgjente reformatore.

Misioni kryesor i prokurorisë Speciale Publike është hetimi dhe ndjekja e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjëshme të komunikimeve, me qëllim të realizimit të së drejtës nëpërmjet parimit të sundimit të së drejtës.

Prokuroria Speciale Publike është themeluar për tërë teritorin e Republikës së Maqedonisë, kurse selinë e ka në kryeqytetin Shkup.

Në ligjin për prokurori publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjëshme të komunikimeve kemi definimin koncizë të termave të rëndësishme si në vijim:

„Ndjekja e paligjëshme e komunikimeve” definohet si ndjekje e paautorizuar e të gjitha komunikimeve të realizuara në periudhën në mes të viteve 2008 dhe 2015, duke përfshirë por jo të kufizuara në audio inçizimet dhe transkriptet të parashtruara deri te Prokuroria Publike para 15 korrikut të viti 2015. 18

Si *„prokuror publik për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjëshme të komunikimeve”* është prokurori publik zgjedhur në

pajtim me nenin 3 nga vet ligji për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve në pajtim me paragrafin (1) nga neni 2.

„Prokuroria publik për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve” është Prokuroria me të cilën udhëheq prokurori publik siç është definuar në paragrafin (2) të këtij neni, duke i përfshirë prokurorët publik të zgjedhur në këtë Prokurori, hetuesit, ekspertët, nepunësit profesional dhe administrativë.⁶⁷

Me ligjin përprokurorinë publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve, rregullohet jurisdiksioni, themelimi, shfuqizimi, organizimi dhe funksionimi i Prokurorisë Speciale Publike, bazat për emrinin dhe shkarkimin e prokurorit publik për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve dhe çështjeve tjera në lidhje me punën e prokurorisë.

Për çdo gjë që nuk është rregulluar me këtë ligjë, zbatohet Ligji për Prokurorinë Publike dhe rregullativat tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë.

Prokuroria publikepër ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve është organizuar sipas parimeve të hierarkisë dhe subordinimit (vartësisë).

Funksioni i Prokurorit Publik në këtë Prokurori Publike është kryer personalisht nga Prokurori Publik i cili udhëheq me prokurorinë dhe nga prokurorët publik të zgjedhur në Prokurorinë Publike.

Prokurorët Publik të cilët i ndihmojnë prokurorit Special Publik janë zgjedhur nga Këshilli prokurorëve publik me propozim të Prokurorit Special Publik.

Prokurori special publik emëron dy zëvendësit e tij të cilët i ndihmojnë në funksionin e tij udhëheqës me qëllim të kryerjes së punëve në kohë dhe në mënyrë kualitative.

Nga ana e prokurorës speciale publike Katica Janeva, zgjidhen prokurorët publik të cilët inkuadrohen në përbërjen si ndihmësit e saj, me çka zgjerohet përbërje e ekipit të saj. Mandati i prokurorëve të zgjedhur publik nuk do ta tejkaloj mandatin e prokurorit publik.

⁶⁷Ligji për prokurorinë publikepër ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM, faq. 2 - nr. 159, 15 shtator 2015

- **Historia e SPS**

Prokuroria speciale publike (shkurt: PSP) - prokuroria publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve, e cila përfaqëson edhe emërtimin zyrtarë të të gjithë prokurorisë.

Prokuroria speciale publike rrjedhë nga marrëveshja e Përzhinos, marrëveshje e nënshkruar në mes të liderëve të katër partive më të mëdha politike për zgjidhjen e krizës politike në Maqedoni. PSP është formuar me Ligjin për prokurori publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve. Në detyrën Prokuror Special publik, Këshilli i prokurorëve publik më 15 shtator të vitit 2015 e ka zgjedhur Katica Janeva.⁶⁸

Me propozim të Katica Janeva më 14 tetor të vitit 2015, nga ana e Këshillit të prokurorëve publik janë zgjedhur prokurorët publik Elizabeta Josifoska, Fatime Fetai, Stevço Donçev, Burim Rustemi, Lubomir Llape, Marija Gorgeva, Lejla Kadriu si prokurorë publik të cilët i ndihmojnë Prokurorit publiku cili udhëheq me Prokurorinë speciale publike.⁶⁹

Më 4 nëntor të vitit 2015, pas propozimit të përsëritur nga ana e Prokurorit publik i cili udhëheq me PSP, nga ana e Këshillit të prokurorëve publik janë zgjedhur prokurorët publik Gavril Bubevski, Lençe Ristovska, Trajçe Pelivanov, Artan Ajro dhe Lile Stefanova

Kushtet për zgjedhjen e prokurorit publik

Funkcionine prokurorisë publike në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë e ushtron prokurori publik i Republikës së Maqedonisë dhe prokurorët publik në atë prokurori. Në këtë rastë jemi të koncentruar në rastin me PSP, gjegjësishtë Prokuroria speciale publike dhe prokurorët special publik.

Për prokurorë publik mund të emërohet, gjegjësishtë personi i zgjedhur i cili i përmbush kushtet e përgjithshme si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të flasë gjuhën maqedonase,
- të jetë i aftë për punë dhe të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore,

⁶⁸<https://www.alsat-m.tv/mk/212277/>

⁶⁹<http://www.jonsk.mk/za-nas/>

- të ketë mare diplomë universitare si jurist i diplomuar në Republikën e Maqedonisë apo diplomë të nostrifikuar nga shteti i huaj dhe
- të ketë të dhënë provimin e jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë.

Përveç këtyre kushteve duhet ti plotësojë edhe kushtet për stazhin e punës, varësishtë se për cilën prokurori bëhet fjalë.

Prokurori publik para marrjes së detyrës së prokurorit publik jep deklaratë solemne.

4.6 Kompetencat dhe detyrat e prokurorëve special publik

Prokurori publik ndërmer kontrollin mbi lëndët të cilat bëjnë pjesë në kompetencat reale të Prokurorisë publike në cilën do qoftë fazë të procedurës⁷⁰.

Pas kërkesës me shkrim nga Prokurori publik, prokuroritë publike janë të obliguar, në afat prej tetë ditësh, të dorzojnë cilën do qoftë lëndë mbi të cilën procedojnë në mënyrë që të vendos se a i përket lënda kometencës së Prokurorit special publik, në pajtim me autorizimin e tij/saj të përcaktuar me këtë ligj⁷¹.

Në periudhën e raportit Prokurori publikepër ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjëshme të komunikimeve dhe ekipi i zgjedhur në mënyrë të palodhëshme dhe me përkushtim punon në drejtim të realizimit të detyrës për të cilën është formuar kjo Prokurori publike, duke u ballafaquar me të gjitha sfidat të cilat paraqiten para tyre.

Nëse analizohet periudha dhe kushtet kur ka filluar të funksionoj kjo Prokurori publike, si dhe periudha kur është zgjedhur ekipi i prokurorëve, mundë të sjellim përfundim se kjo Prokurori Publike faktikisht funksionon tri vite deri më sot. Por edhe përkundër kësaj shtate, në periudhën e raportimit nga ana e kësaj Prokurorie publike në mënyrë të plotë janë respektuar detyrimet ligjore edhe atë si në aspektin e punës profesionale dhe transparente, ashtu edhe në aspektin e sjelljes adekuate me materialet nga ndjekja e paligjëshme e komunikimeve dhe lëndët të cilat janë formuar para prokurorive publike dhe gjykatave në Republikën e Maqedonisë, dhe janë të lidhura apo rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjëshme të komunikimeve.

⁷⁰Ligji për prokurorinë publikepër ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjëshme të komunikimeve, Gazeta Zyrtare e RM, faq. 2 - nr. 159, 15 shtator 2015

⁷¹Po aty.

Procesuimi lëndor i kësaj Prokurorie publike fletë se në periudhën e raportimit janë filluar shumë procedura parahetimore, nga të cilat një pjesë janë në një fazë të avancuar, kurse një pjesë kanë kaluar edhe në fazën e hetimit. Njëkohësisht për një periudhë të shkurtër kohore është ndërmarrë një numër i madh i veprimeve procedurale. Në këtë drejtim theksohet se prokuroria publike, nxitë dhe ndjek procedura penale në përputhje me ligjin për procedurë penale në kuadër të së cilës si tani ashtu edhe në të ardhmën do të mbrohen dhe garantohen të drejtat e të gjithë pjesëmarsve në procedurë, si në aspektin e sigurisë së tyre, ashtu edhe në aspektin e sigurimit të të gjitha të drejtave procedurale.

Gjithashtu, mendohet se Kuvendi në funksion të realizimit të baraspeshës adekuate në mestë të interesave private dhe interesit për informimin e publikut është e nevojshme që të tregoj gatishmëri për respektimin e përpiktë të standarteve europiane në raport me mendimin e fundit të komisionit të Venecias dhe rekomandimet të cilat theksojnë se është e nevojshme që të lejohet publikimi i materialeve të cilët janë me interes publik si dhe definimin e saktë të detyrimit për dorzimin e materialeve të kësaj prokurorie publike e cila nuk duhet të përjashtoj publikimin e materialeve të tilla të cilat kanë të bëjnë me punë që janë me interes publik.

Prokurorët publik të cilët i ndihmojnë prokurorët special publik, nuk kanë të drejtë të sjellin urdhëra dhe akuza, kurse kanë të drejtë që ta përfaqësojnë Prokurorin special publik para gjykatës kompetente. Prokurorët publik të cilët janë emëruar në Prokurorinë publike kanë përgjegjësi vetëm para Prokurorit special publik i cili është përgjegjës për vlerësimin e punës së tyre.

Funksioni kryesor i kësaj Prokurorie publike, si dhe të prokurorëve të zgjedhur publik, është në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Maqedonisë dhe përfaqëson hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cialt rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve. Ndjekje e pautorizuar e komunikimeve mund të definohet si ndjekje e paautorizuar e të gjitha komunikimeve të realizuara në periudhën në mes të viteve 2008 dhe 2015, duke përfshirë por jo edhe të kufizuara në inçizimet audio dhe transkripte të paraqitura deri te Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë para 15 korrikut të vitit 2015.

Prokuroria speciale publike i përfshin edhe hetuesit, ekspertët, shërbimet profesionale dhe administrative. Në pajtim me vendosjen konceptive organizative të kësaj Prokurorie publike në bazë të autonomisë së dhënë me ligjë që në mënyrë të pavarur të hetoj veprat penale të lidhura të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimit, si përkrahje ndaj Prokurorit

special publik dhe ekipit të prokurorëve publik u paraqit nevoja e formimit të ekipit të hetuesve. Ekipin e hetuesve e përbëjnë nëpunësit policorë nga Ministria e punëve të brendshme dhe Drejtorisë së policisë financiare, si dhe bashkëpunorët profesional të cilët janë përfshirë në ekipin e hetuesve të kësaj prokurorie⁷².

Shërbimin profesional dhe administrativ e përbëjnë nëpunësit e prokurorisë publike dhe personat të cilët kryejnë punë teknike dhe ndihmëse. Duke marrë parasysh karakterin specifik të punës dhe detyrave të punës të cilat i kryejnë të punësuarit, statusi i tyre është rregulluar me ligj.

Shërbimi i Prokurorisë publike të kësaj prokurorie bazohet në parimin e ligjshmërisë, profesionalitetit, profesionalizmit dhe kompetencës, përgjegjësisë, efikasitetit, etikës profesionale, paanshmërisë dhe objektivitetit, besueshmërisë, parandalimit të konfliktit të interesit, kursimit dhe parimin e vendosjes hierarkike.⁷³

4.7 Roli i operatorëve mobil gjatë ndjekjes së komunikimeve

Ndjekja dhe inçizimi i komunikimeve telefonike si dhe komunikimeve tjera elektronike, paraqet masë hetimore sipas Ligjit për procedurë penale e cila zbatohet kur ekzistojnë bazat e dyshimit se përgatitet, është duke u kryer apo është krye vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg nga së paku katër vite, si dhe për vepra penale për të cilët ekziston baza e dyshimit se përgatiten, është duke u kryer apo është krye vepër penale nga ana e grupeve të organizuara, bandave apo organizatave tjera keqbërëse, në mënyrë që të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të cilat janë të nevojshme për udhëheqjen me sukses të procedurës penale, të cilat në menyra tjera nuk mund të sigurohen apo sigurimi i tyre do të lidhej me vështirësi më të mëdha.

Ndjekja e komunikimeve është rregulluar me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve dhe Ligjin për procedurë penale, ku qartë është theksuar se ndjekja e komunikimeve duhet të kryhet në mënyrë dhe procedurë me të cilën nuk kërcënohen të drejtat dhe liritë e njeriut dhe çdo keqpërdorim paraqet vepër penale sipas Kodit penal të RM.

⁷²Ligji për prokurori publike „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ numër 150 onga12.12.2007 vit.

⁷³<http://www.jonsk.mk>

Në gjithë këtë sistem të ndjekjes së komunikimeve janë përfshirë edhe operatorët mobil të cilët janë të obliguar që të respektojnë rregulla të caktuara të cilat janë paraparë në dispozitat e Ligjit për komunikime elektronike i cili është sjellë në shkurt të viti 2014.

- **Obligimi i operatorëve**

Sipas Ligjit për komunikimet elektronike operatorët janë të obliguar që të sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme teknike për të mundësuar ndjekjen e komunikimeve në rrjetet e tyre. Operatorët janë të obliguar me financa të veta të mundësojnë dhe ti mirëmbajnë pajisjet, interfejsin adekuat dhe të vendosin lloje të komunikimeve elektronike për përcjelljen deri te organi kompetent për ndjekjen e komunikimeve, me qëllim që të mundësohet ndjekja e komunikimeve në rrjetin e tyre.⁷⁴ Gjatë furnizimit me pajisje dhe interfejsa, operatorët janë të obligura që nga organi kompetent për ndjekjen e komunikimeve të kërkojnë specifikime teknike për llojin dhe karakteristikën e të njejtave.

Organi kompetent për ndjekjen e komunikimeve i përcakton masat dhe standardet për sigurinë e informacionit, të cilat duhet ti zbatoj operatori i rrjeteve apo shërbimeve publike të komunikimit elektronik në lidhje me obligimet e tij për ndjekjen e komunikimeve. Në rastet kur operatorët kanë zbatuar kompresion apo kriptombrojtje të komunikacionit, janë të obliguar që ta heqin të njejtën, para se ta dorzojnë përmbajtjen e shërbimit të komunikimeve të ndjekura deri te organi i autorizuar për ndjekjen e komunikimeve.

Operatorët kanë për obligim që ti mundësojnë organit të autorizuar për ndjekjen e komunikimeve, ndjekjen e komunikimeve në kohë reale. Informacioni për ndjekjen e komunikimeve duhet të jetë në dispozicion menjëher pas përfundimit të komunikimit, kurse ndjekja e komunikimeve duhet të jetë pandërprerje gjatë gjithë kohës deri sa ajo vazhdon. Operatorët gjithashtu kanë obligim që të sigurojnë lidhje të saktë dhe unike të informacionit për komunikimin e ndjekur me përmbajtjen e komunikimit e cila ndiqet. Operatorët duhet të sigurojnë që personi komunikimi i të cilit ndiqet apo personat e tjerë të paautorizuar që mosë të vërejnë çfardo llojë ndryshimi në kualitetin e shërbimit të komunikimit e cila mundë të shkaktohet me zbatimin e masës së ndjekjes së komunikimeve. Funksionimi i shërbimit të ndjekjes së komunikimeve duhet të mbetet e pandryshuar për personin komunikimi i të cilit ndiqet. Operatorët duhet të sigurojnë siguri të njejtë apo më të lartë dhe kualitet të shërbimit të ndjekjes

⁷⁴Ligji për komunikimet elektronike gazeta zyrtare e RMV nr.39 nga 25.02.2014

së komunikimit nga siguria dhe kualiteti i shërbimit të komunikacionit të cilat i janë mundësuar personit komunikimi i të cilit ndiqet. Agjencioni për komunikimet elektronike mundë të ngrëjë procedurë për mbikqyerje mbi operatorin, me kërkesë të organit të autorizuar për ndjekjen e komunikimeve.



Fotografia 4. Personi i cili është përgjegjës për ndjekjen e komunikimeve

- Cilat të dhëna kanë për obligim që ti ruajnë?

Operatorët janë të obliguar që ti ruajnë të dhënat e nevojshme për ndjekjen dhe identifikimin e burimit të komunikimit, për identifikimin e destinacionit të komunikimit, për identifikimin e datës, orës si dhe të kohëzgjatjes së komunikimit, për identifikimin e llojit të komunikimit, për identifikimin e mjetit të komunikimit të shfrytëzuesit apo të asaj e cila konsiderohet se është e tij, si dhe të dhëna të tjara që janë të nevojshme për të identifikuar lokacionin epajisjes së komunikimit mobil. Operatorët janë të obliguar që ti ruajnë këta të dhëna⁷⁵ për komunikimet elektronike, të cilat janë krijuar apo përpunuar nga ana e tyre gjatë sigurimit të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike apo shërbimeve me qëllim që të mundësohet qasje deri te këto të dhëna me qëllim parandalimin apo zbulimin e veprave penale, në mënyrë që të udhëhiqet procedura penale ose kur ato e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë. Operatorët janë të obliguar që të dhënat dhe të gjitha informatat e nevojshme që

⁷⁵Ligji për komunikime elektronike gazeta zyrtare e RMV nr.39 nga 25.02.2014

kanë të bëjnë me ato të dhëna, që pas kërkesës tua dorzojnë organeve kompetente, me kushtet dhe procedurat e parapara me ligj.

- **Dispozitat penale**

Gjopa në shumë prej 7% deri 10% nga të ardhurat e përgjithshme vjetore të subjektit juridik (të paraqitura në shuma absolute) të realizuara në vitin e veprimtarisë e cila i paraprinë vitit kur është kryer kundërvajta apo nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara për një periudhë më të shkurtë kohore të vitit i cili i paraprinë kundërvajtjes, nëse në atë vit personi juridik ka filluar me punë, të njejtit do ti shqiptohet nëse⁷⁶:

- kryen në mënyrë të paautorizuar dhe joligjore përgjim, ndjekje, ruajtje, inçizim, mbajtje apo çdo formë të përcjelljes apo mbikqyrjes mbi komunikimet,
- nuk i siguron të gjitha kushtet e nevojshme teknike në mënyrë që të mundësoj ndjekje të komunikimeve në rrjetin e tij,
- me harxhimet e veta nuk siguron apo mirëmbanë pajisjet, interfejsin adekuat apo nuk instalon linja të komunikimit elektronik për përçarje deri te organi i autorizuar për ndjekjen e komunikimeve,
- nuk kërkon nga organi i autorizuar për ndjekjen e komunikimeve specifikim teknik për llojin dhe karakteristikat e pajisjeve dhe interfejsit,
- Nuk i mundëson organit të autorizuar për ndjekjen e komunikimeve, ndjekjen e komunikimeve në kohë reale, informacioni për komunikimin e ndjekur nuk është në dipozicion menjëher pas përfundimit të komunikimit apo ndjekja e komunikimit nuk është e pandërpretë gjatë gjithë kohës prderisa ajo zgjatë.
- **Sanksionet dhe dënimet për inçizimet e paautorizuara**

Sipas rregullativës pozitive në Republikën e Maqedonisë inçizimi i paautorizuar, përgjimi dhe inçizimi me zë është rreptësishtë i ndaluar dhe është e paraparë si vepër penale në Kodin penal të RM. Ndjekjen dhe inçizimin e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike, ndjekjen dhe inçizimin në shtëpi, hapësirë të mbyllur apo të rrethuar, e cila i takon asaj shtëpie apo hapësirës së punës e shënuar si hapësirë private apo në veturë ose në

⁷⁶Ligji për kundërvajtje.

hyrjet e atyre hapësirave mundë të caktojë vetëm gjykata si masë e veçantë hetuese sipas kushteve rreptësishtë të përcaktuara.

Të dhënat e fituara nga këto masa hetuese janë fshehtësi zyrtare dhe është e ndaluar çdo llojë distribuimi dhe publikim me qëllim të mbrojtjes së personit të interesuar, si dhe të respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë e cila është e garantuar me kushtetutë.

Sipas Kodit penal të RM si vepër penale kundër të drejtave personale është inçizimi i paautorizuar në nenin 152. Sipas këtij neni ai i cili në mënyrë të paautorizuar do të bëjë inçizime fotografike, filmike apo video të personit tjetër apo të hapësirave të tija personale pa pëlqimin e tij, duke e shkelur privatësin e tij apo ai i cili inçizimet e tilla drejtëpërsëdrejti ia dorzon personit të tretë apo ia tregon atij apo në mënyra tjera i mundëson që të njihet me ato, do të dënohet me dënim me para apo me burg deri në një vit.⁷⁷

Si rrethanë rënduese, është nëse inçizimin e paautorizuar e kryen personi zyrtarë, në ato rastë janë paraparë dënime me burgë nga tre muaj deri tre vite.

Për përgjimë të paautorizuar dhe inçizime me zë është paraparë dënim me para apo burgë deri një vit, nëse përgjimin e paautorizuar dhe inçizimin me zë e ka kryer personi zyrtarë atëher është paraparë dënimi me burgë nga 3 muaj deri 3 vite. Mbrojtja e kësaj forme të veprës është parasegjithash për mbrojtjen e jetës private, dhe parandalimin që ato inçizime të keqpërdoren nga ana e kryersit për qëllime të ndryshme, siç janë shantazhi, shkelja e reputacionit, zhvatja dhe të ngjashme.

⁷⁷Kodi penal i RM, neni 152.

VII Përfundimi

Krimi i organizuar është një fenomen relativisht i ri në Republikën e Maqedonisë. Në paraqitjen e krimit të organizuar në masë të madhe dhe seriozisht ndikuan faktorë të shumtë si: rritja e numrit të organizatave kriminale në nivel global, problemet e sigurisë në rajon të shoqëruara me embargo, problemet e brendshme tranzitore.

Republika e Maqedonisë nga ana tjetër për shkak të pozitës së saj gjeografike njëkohësisht është prekur nga krimi nderkufitar.

Rreziqet e përmendura të sigurisë bartin rrezikun nga ndikimi negativ mbi organet dhe institucionet shtetërore të të gjithë niveleve dhe në subjektet ekonomike. Rezultati përfundimtar nga këto aktivitete mund të sjell deri te kriminalizimi i marrëdhënieve shoqërore dhe intensifikimin e formave të terrorizmit dhe krimit të organizuar (vrasjeve dhe formave të tjera të krimit të dhunshëm), veçanërisht shtimi i të gjitha formave të krimit ekonomik. Të gjitha këto manifestime negative, nëse nuk ndërmerren hapa për luftimin e tyre, mund të kërcënojnë themelet e sistemit politik, juridik dhe ekonomik të shteteve, dhe në të njëjtën kohë të paraqesin katalizatorë për paraqitjen dhe përhapjen e proceseve negative shoqërore.

Në bazë të asaj që u tha deri tani mund të përcaktohet, se krimi i organizuar dallohet nga forma tradicionale e kriminalitetit gruporë, siç janë bandat dhe shoqëritë kriminale në bazë të ekzistimit të më shumë se tre shenjave të numëruara.

Kriminaliteti i organizuar nuk njihet kufi. Organizatat kriminale të këtij lloji tentojnë që të kyqen në sistemin ekzistues dhe në institucionet të cilët realizojnë në bazë të rregullës ndonjë veprimtari ekonomike. Këta organizata realizojnë forma të ndryshme të ndikimit që ti mbajnë në dorën e tyre njerëzit nga organet dhe institucionet shoqërore përgjegjëse për dhënien e lejeve të caktuara, të cilët i udhëheqin politikën ekonomike dhe vendosin për marrëveshjet e mëdha ekonomike. Atë e bëjnë në atë mënyrë që i kyqin njerëzit e tyre në nivelet më të larta të pushtetit, me qëllim të korruptimit dhe funksionerëve të ndryshëm.

Me kushtet moderne kërcënimi nga ky kriminalitet shumë i rrezikshëm është në një nivel shumë të lartë në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe pothuajse nuk ka shtet që nuk është infektuar nga format e paraqitjes së llojllojshme të tyre. Pjesëmarrësit e tyre, duke i përdorur të gjitha mjetet: nga ato të cilat marrin lëshime ligjore deri te shantazhimi i hapur, kërcënimi, dhënia

e ryshfetit, lidhje politike dhe lidhje të tjera shumë të theksuar, me mospërfilljen dhe me dhunë, kryejnë krime të llojeve të ndryshme të cilët u shkaktajnë dëme të mëdha dhe të pariparueshme shoqërive konkrete si dhe bashkësisë ndërkombëtare në përgjithsi. Për shkak të karakterit ndërkombëtar lëvizja e theksuar dhe fleksibiliteti për gjetjen e metodave të reja për veprim sjell që organizatorët shpeshherë mbeten të panjohur për organet e ndjekjes, kurse ato të cilët janë të njohur, është vështirë të numërohen dhe jo më të kapen. Në këtë kuadër padyshim vërtetohet teza se rrënjët e kriminalitetit qëndrojnë në karakterin e strukturës shoqëro-ekonomike, në tjetërsimin e njeriut, në kushtet materiale dhe shpirtërore të jetës dhe nevoja individuale dhe nga orientimi që nevojat dhe problemet të arihen dhe zgjidhen me mjete të palejueshme.

Faktorët e drejtëpërdrejtë etiologjik para se gjithash duhet të kërkohen në sferën e ndryshimeve të shpejta shoqërore dhe në ndryshimet në marrëdhëniet ekonomike dhe politike, si dhe në marrëdhëniet dhe lidhjet interaktive në nivel global: migrimet, komunikimet, transportet, rrjedhjet financiare etj. Në rritjen e krimit të organizuar veçanërisht ndikojnë edhe faktorët që janë në lidhje direkte me tregun dhe me funksionimin e shtetit. Dobësia në funksionimin e shtetit, në thelbë rrjedh nga mbizotrimi i politikës mbi të drejtën, nga mosfunksionimi i shtetit ligjorë dhe mosrespektimi i parimit të ligjshmërisë.

Nga e gjithë ajo që është treguar në këtë punim, në mënyrë mjaft të qartë shihet se veprimtaria e krimit të organizuar fillimisht organizohet dhe nisë në mënyrë të fshehur dhe pastaj heshtazi zhvillohet gradualisht.

Kjo veprimtari kështu në mënyrë graduale behet rrezik kërcënues për tërë shoqërinë.

Me këtë nënkuptojmë se, krimi i organizuar edhe pse i padukshëm, gjithnjë është prezent si formë vrasëse e një shoqërie. Prezenca e krimit të organizuar në shoqëri, në masë të madhe është e ndihmuar dhe nga vete autoritetet dhe politika në pushtet, pikërisht situat kjo e paraqitur përmes rasteve të përgjimeve të cilat janë parashtruar në punim.

Nisur nga kjo, lufta kundër këtij fenomeni këkron një angazhim të pandërprerë, të përhershëm dhe të qëndrueshëm.

Literatura e përdorur

1. Vllado Kambovski & Ismail Zejneli. E drejta Penale. *pjesa e pergjithshme, Tetove, 2018*
2. Rexhep Gashi Krimi i organizuar, Prishtine, 2004
3. Ismail Zejneli & tjere Aspekte juridike te krimit te organizuar, Tetove, 2007
4. Vlado Kambovski Organiziran kriminal, Skopje, 2005
5. Ginter Kajzer Kriminologija, Skopje, 1996
6. Ragip Halili Kriminologjia, Prishtinë, 2011
7. Veton Vula Kriminaliteti i organizuar, Prishtine, 2017
8. Arnaudovski Lupço, Represioni në funksion të parandalimit të kriminalitetit të organizuar transnacional, Universiteti Shën.Kirili dhe Metodij, Qendra për edukimin e kuadrit nga fusha e sigurisë, Fakulteti i sigurisë, Shkup, 2002.
9. Boshković Miqo, Kriminaliteti i organizuar, Akademia policore, Beograd, 1995.
10. Boshković Miqo, Kriminaliteti i organizuar transnacional, Akademija policore, Beograd, 2003.
11. Vitllarov T., Kallajxhiev G., Llabović Miodrag, Stojanovski Trpe, Probleme të tjera praktike gjatë bashkëpunimit dhe koordinimit në parandalimin e krimit të organizuar, Shkup, 2005.
12. Grubač Momčilo, „Krimi i organizuar në shtetet në tranzicion”, Përmbledhja e punimeve të fakultetit Juridik në Split, nr. 4/2009.
13. Ignjatović Gjorgje, Krimi i organizuar: pjesa e veçantë, akademia policore, Beograd, 1998.
14. „Ndryshimi i Kodit Penal”, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.80/99
15. „Ligji për prokurorinë publike”, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2007, 111/2008.
16. Ligji për prokurorinë publike për ndjekjen e veprave penale të cilat janë të lidhura dhe të cilat rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve, Gazeta zyrtare e RM, nr. 159, 15 shtator 2015.
17. „Ligji për procedurën penale”, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 115/1997, 83/2008.

18. Llaboviq Miodrag dhe Nikollovski Marjan, Krimi i organizuar dhe korupcioni, Fakultet i sigurisë, Shkup, 2010.
19. Malish Sazdovska Marina, Kriminalistika Ekologjike, Solarisrint, Shkup, 2009.
20. Malish Sazdovska Marina, Doracaku për ciklin e kundërzbulimit, Jofi-sken, Shkup, 2005.
21. Mojanoski C., Metodologjia e hetimit të fenomeneve të sigurisë (ligjeratat-skriptat e brendshme), Akademia policore, Shkup, viti 2007.
22. Mojanoski C., Karakteristikat e hulumtimit statistikor të kriminalitetit. „Siguria” nr.2/1995 vit,
23. Prokuroria Speciale publike, ueb faqja zyrtare: <http://www.jonsk.mk>
24. Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të brendshme, Byroja për sigurinë publike.
25. Kambovski Vllado, Krimi i organizuar, „2-gusht”, Shtip, 2005.
26. Llaboviq Miodrag, Qeveria korumpon, De Gama, Shkup, 2006.
27. Lajmon M dhe Poter G., Krimi i organizuar, Magor, 2009.
28. Manevski Mihajllo, Korupcioni në RM: masat preventive dhe dënuese, për parandalimin, Shkup, 2005.
29. Maslesha r., „Ndikimi I krimit të organizuar në stabilitetin politik dhe të sigurisë në rajon”, Temat kriminalistike, nr.3-4, 2003, Fakulteti i shkencave kriminalistike në Sarajevë.
30. Raporti i parë gjashtëmujorë për punën e prokurorisë nga 15.09.2015 deri 15.03.2016, kyqur nga, <http://www.jonsk.mk>
31. „Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedure penale”, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 15/05.
32. „ Ligji për procedure penale”, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 15/97, 44/02.
- 26 „Ligji për ndjekjen e komunikimeve”, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 121/06.
27. Ligji për komunikimet elektronike (E shpallur në Gazetën zyrtare të RM, nr 39 nga 25.02.2014 vit)

28. Tuxharovska- Gjorgjievska E. Raporti mbi monitorimin e rreziqeve të korupsionit dhe krimet të organizuar, Projekt : Luftimi I korupsionit dhe krimet të organizuar, Qendra Maqedonase për bashkëpunim Nderkombëtar.
29. Todorovska Gjurçeska S. (2011), Kriminologjia, Shkup.
30. Kushtetuta e RM
31. Ligji për policinë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 114 nga 03.11.2016)
32. Katarina Hofman, 'The impact of organized crime on democratic governance: focus on Latin America and the Caribbean', in FES Briefing Paper, No. 13, 2006,
33. Kimberley L. Thachuk (ed.), Transnational Threats: Smuggling and Trafficking in Arms, Drugs, and Human Life, Praeger Security International, Westport, CT, 2007;
34. Klaus von Lampe, 'The interdisciplinary dimensions of the study of organized crime', in Trends in Organized Crime, Vol. 9, No. 3, 2006,
35. Klaus von Lampe, Organised crime in Europe: Conceptions and realities, Policing: A journal of policy and practice, 2(1), 2008,
36. Larry J. Siegel and Brandon C. Welsh, Juvenile Delinquency: Theory, Practice, and Law, Wadsworth, Belmont, CA 2009,
37. Luke Dowdney, Children of the Drug Trade: A Case Study of Children in Organized Armed Violence in Rio de Janeiro, 7Letras, Rio de Janeiro, 2003.
38. Michael Woodiwiss and Dick Hobbs, 'Organized evil and the Atlantic Alliance: moral panics and the rhetoric of organized crime policing in America and Britain' , në British Journal of Criminology, Vol. 49, 2009.
39. Terrorizmi ndërkombëtar , Kolë Krasniqi Prishtinë 2010.
40. Terrorizmi, Haki Demolli Prishtinë 2002.
41. Kriminologjia Ragip Halili, Prishtinë 2016